


Fletë pune për nxënësit I-1.2: Pasqyra ime

 emri dhe mbiemri		
kënga e dashur	filmi i dashur	kafsha e dashur
ushqimi i dashur	sporti i dashur	libri i dashur

Fletë pune për nxënësit I-1.3: Unë mundem ...

Shikoje listën dhe në katrorin e zbrazët para fjalisë vendose njërën nga këto shenja:



- Këtë e bëj super!



-Po mësoj ta bëj.



- Ende nuk di ta bëj.

UNË MUNDEM...

☐

të kujdesem për higjienën time personale.

☐

të lexoj dhe të shkruaj.

☐

të vizatoj.

☐

të kujdesem për fëmijët më të vegjël.

☐

në mënyrë të barabartë të bisedoj me të rriturit.

☐

t'i riparoj gjërat e prishura.

☐

të përdor kompjuter.

☐

të gatuaj.

☐

ta rregulloj dhomën time.

☐

të këndoj dhe të vallëzoj.

☐

t'ua ndryshoj mendimin njerëzve për diçka.

☐

të punoj me disa lloje të makinave (për shpim, mikser).

☐

të flas në telefon.

☐

t'i kuptoj ndjenjat e njerëzve .

☐

ta gëzoj dikë.

☐

_____.

☐

_____.

Këtu shkruaje nga një gjë e cila për ty është shumë e rëndësishme për ta arritur/bërë për një javë, për një muaj dhe për një vit.

Një javë _____

Një muaj _____

Një vit _____



BABAI-SERAFIMOVSKI	NËNA-SHOTAREVSKI
NËNA-SERAFIMOVSKI	BIRI-SHOTAREVSKI
BIJA-SERAFIMOVSKI	BABAI-BALLAZHI
BIRI-SERAFIMOVSKI	BIRI-BALLAZHI
BABAI-PETREVSKI	BABAI-HASANOV
NËNA-PETREVSKI	NËNA- HASANOVA
BIRI-PETREVSKI	BIJA- HASANOVA
GJYSHJA – PETREVSKI	BABAI-NAJDENOSKI
BABAI-HRISTOVI	BIJA-NAJDENOSKI
NËNA-HRISTOVI	BIRI-NAJDENOSKI
BIRI-HRISTOVI	BABAI-SHABANI
BIRI-HRISTOVI	NËNA-SHABANI
BIJA-HRISTOVI	BIRI-SHABANI
GJYSHJA- HRISTOVI	NËNA-STOILLKOVIQ
GJYSHI- HRISTOVI	BIJA-STOILLKOVIQ
	BIJA-STOILLKOVIQ
NËNA-LAMAXHEMA	BABAI-LAMAXHEMA
BIRI-LAMAXHEMA	BIRI-LAMAXHEMA

Fletë pune për nxënësit I-2.2: Përgjegjësitë e mia

asnjëherë	pak	shumë	çdoherë	Përgjegjësitë ndaj vetvetes
				Përpiqem ta mbaj të pastër trupin, mos të më vijë ere e keqe dhe mos “të më ngjiten” flokët.
				Ushqehem me ushqim të shëndetshëm, edhe pse më pëlqen shumë shija e hamburgerit, e çipsit dhe e picës.
				I laj dhëmbët ashtu si më rekomandon dentisti (uh!) im.
				Shpesh e dëgjoj zërin e ndërgjegjes.
				Kujdesem për veshjen time, veçanërisht për atë që e pëlqej shumë dhe që e mbaj në shkollë.
asnjëherë	pak	shumë	çdoherë	Përgjegjësitë ndaj familjes sime
				Ndihmoj në detyrat e shtëpisë, si për shembull: në larjen e enëve ose në hedhjen e mbeturinave me erë të keqe.
				E pastroj dhomën dhe i mënjanoj topat e pluhurit që mblidhen nën krevatin tim.
				Jam i dashur/e dashur me anëtarët e familjes sime, madje edhe me hallën time, e cila vazhdimisht më përqafton me sa fuqi që ka dhe me puth.
				Kujdesem për ledhatakun tim edhe kur ai harron se ku duhet ta kryejë nevojën.
asnjëherë	pak	shumë	çdoherë	Përgjegjësitë në shkollë
				I respektoj rregullat në shkollë, edhe pse disa nuk më pëlqejnë fare.
				Jap gjithçka nga vetvetja për të gjitha detyrat dhe testet, madje edhe në lëndët që nuk i kam për qejfi.
				Rregullisht i mbaj me vete librat, fletoret dhe pajisjet e tjera shkollore, ndërsa lajmërimet për prindërit i dërgoj në shtëpi pa kurrfarë ndërhyrjesh.
				I bëj detyrat e shtëpisë edhe kur luan emisioni im i dashur në televizion.
asnjëherë	pak	shumë	çdoherë	Përgjegjësitë ndaj mjedisit
				Çdoherë e hedh mbeturinën në vendin e duhur, madje nëse duhet i mbaj xhepat plot derisa të gjej kosh mbeturinash.
				I respektoj ligjet dhe rendin edhe atëherë kur shokët e mi më detyrojnë t’i thyej.
				I shuaj dritat në dhoma dhe në koridore kur nuk ka askush aty.
				Nuk këpus gjethe pranë rrugës kur kaloj aty pari.

Fletë pune për nxënësit I-3.1: Si ndjehem...



1. Kur dikush më merr diçka pa më pyetur, ndjehem....
2. Kur më ndodhë që të gaboj, ndjehem....
3. Sikur të më ndiqte arusha, do të ndjehesha....
4. Kur dikush më falënderon për diçka që kam bërë, ndjehem....
5. Sikur dikush të më quante “pulë marroqe”, do të ndjehesha...
6. Sikur të duhej të rri gjithë ditën vetë në shtëpi, do të ndjehesha...
7. Kur ma blejnë atë që e kërkoj, ndjehem....
8. Kur ta shoh simpatinë time me ndonjë tjetër, ndjehem....
9. Kur marr ndonjë dhuratë të papritur, ndjehem....
10. Kur nuk mund t’i ndihmoj shoqes sime që ka problem, do të ndjehesha...
11. Kur nuk fle tërë natën, ndjehem....
12. Kur askush nuk e vëren se kam bërë diçka për çka jam munduar shumë, ndjehem....
13. Kur duhet të përgjigjem për notë, ndjehem....
14. Kur dikush nuk e përmbush atë që ma ka premtuar, ndjehem....
15. Sikur të më ftonin të aktroj në film, do të ndjehesha...
16. Kur shokët nuk më ftojnë të luaj me ata, ndjehem....
17. Kur në shkollë marr notë të dobët, ndjehem....
18. Kur nuk mund të mos mendoj për atë që më pëlqen, ndjehem....



ZEMËRIM

DASHURI

DËSHPËRIM

FRIKË

FAT



SHQETËSIM

FASCINIM

BRENGOSJE


TURPËRIM

ZEMËRIM

HIDHËRIM

KRENARI

PIKËLLIM



Barometri i ndjenjave gjatë ndarjes



1. Është guxim kur e di se ndoshta nuk do të kesh sukses, e megjithatë vazhdon të përpiqesh.

2. Mossuksesi i vetëm është kur nuk ke arritur të përpiqesh.

3. Nuk e njoh askënd që ka arritur të ngjitet në majë pa shumë mund. Kjo ndoshta nuk do të shpie çdoherë në majë, por sigurisht do të shpijë afër majës.

4. Njeriu mëson sa është i gjallë.

5. Kush punon, gabon.

6. Nuk është keq të gabosh, por keq është nëse nuk mëson nga gabimet.

7. Askush nuk ka lindur i dijshëm.

8. Sukses është fat i pastër. Këtë do t'ua thotë secili që nuk ka pasur sukses.

Fletë pune për nxënësit I-5.2b: Kartela me pyetje



Nëse duhet të marrësh medalje për guxim, për cilën punë do ta meritoje atë?

Kur ke qenë krenar me veten tënde që ke arritur t'i ndihmosh dikujt?



A u ke thënë ndonjëherë JO të tjerëve edhe a ke qenë krenar me këtë?

Cila është arritja jote më e madhe fizike?



Në çfarë mënyre mund të shihet se ti je person kreativ?

Kur ke ndihmuar të qetësohen dy persona që janë grindur?



Kur je gëzuar me suksesin e të afërmit tënd si për suksesin tënd?

Kur ke qenë i/e kënaqur që ke punuar sipas planit që e ke përgatitur?



Cili është suktesi i parë, i cili të kujtohet se e ke arritur si i/e vogël?

Përshkruaj diçka për të cilën mendon se është për ty sukses në shkollë.



Përshkruaje një gjë që e konsideron për sukses, ndërsa e ke arritur jashtë shkollës?

Me çka krenohesh në veçanti me vetveten si pjesë e familjes?



Cili është suktesi yt më i ri?

Cili është suktesi yt më i vogël, por shumë i ëmbël?



Cili është i admiruari yt dhe në çka i ngjason atij/asaj?

Kur të ka ndihmuar dikush për herë të fundit që të kesh sukses?



Çfarë këshille për sukses do t'i jepje nxënësit të klasës së parë nga përvoja jote?

Numëroji së paku tre "suksese të vogla" që i ke arritur sot qëkur je zgjuar e deri tash?



Sa suksese e sa mossuksese i ke mesatarisht në ditë?

Sa kohë të është dashur që ta tejkalosh mossuksesin e fundit dhe të përpiqesh rishtazi?



A mund të përkujtohesh në ndonjë frikë tënden apo në ndonjë mendim negativ që nuk të ka lënë të kesh sukses, e që tash e ke tejkaluar?

Kur dhe si je mësuar të flasësh?



Kur ka ndodhur që me të vërtetë të të duhet të punosh shumë që të arrish sukses?

Çka të ka ndihmuar më së shumti ku nuk ke qenë i/ sigurt për suksesin?



Kur ka ndodhur që pas shumë përpjekjeve të pasuksesshme megjithatë ta arrish atë që e dëshiron?

Kush të ka qëndruar pranë dhe të ka ngushëlluar për herë të fundit kur nuk ke pasur sukses që ta arrish atë që e dëshiron?



A je befasuar ndonjëherë edhe vetë nga suksesi personal?

A i ke ndihmuar ndonjëherë ndonjë më të moshuari ose dikujt që ka më shumë përvojë që të arrijë sukses në diçka?



Nëngrupi J0	Nëngrupi P0
1. Nëse gabojnë, gabimisht do t'i mësojnë edhe fëmijët.	Nëse gabojnë, duhet t'i korrigjojnë gabimet që mos t'i mësojnë fëmijët gabimisht.
2. Nëse gabojnë, dëshmojnë se disa gjëra nuk i dinë.	Nuk është ndonjë humbje e madhe nëse diçka nuk dihet, por është keq që ajo të mos pranohet.
3. Nëse ata nuk i dinë disa gjëra, atëherë nuk kanë të drejtë t'u japin nxënësve nota më të ulëta, sepse edhe vetë ata disa gjëra nuk i dinë.	Notat e nxënësve jepen për dituri, por nëse ata nuk kanë mësuar tash, mund të mësojnë më vonë dhe ta përmirësojnë notën.
4. Nëse gabojnë, shfaqin mosrespekt edhe ndaj profesionit të tyre, por edhe ndaj nxënësve.	Respekti dëshmohet edhe në shumë mënyra të tjera, ndërsa më me rëndësi është që arsimtarët të kërkojnë falje dhe ta përmirësojnë gabimin.
5. Nëse gabojnë ata, nxënësit do të zihen me ata dhe nuk do të ketë disiplinë në orë.	Nxënësit mund t'u atregojnë arsimtarëve gabimet, ndërsa arsimtarët duhet të falënderohen dhe t'i nxisin nxënësit që edhe më me kujdes t'i ndjekin dhe t'i korrigjojnë në rast të gabimeve të tjera eventuale.



Nëngrupi J0	Nëngrupi P0
1. Nëse e shprehin mendimin e tyre, prindërit mund të hidhërohen.	Prindi duhet ta vazhdojë bisedën me fëmijën dhe t'i njohë më mirë pikëpamjet e tij.
2. Çka nëse e shprehin mendimin e tyre kur prindërit nuk do t'i dëgjojnë?	Edhe sikur të mos bëjnë ashtu si kërkojnë fëmijët, megjithatë prindërit duhet të dinë se çka duan fëmijët dhe çfarë nevojash kanë.
3. Nëse për gjithçka u tregojnë se çka mendojnë, atëherë nuk do të kenë kurrfarë intimiteti.	Fëmijët nuk duhet t'u tregojnë gjithçka, por duhet ta shprehin mendimin e tyre në lidhje me çështje që kanë lidhje me ata.
4. Nëse sinqerisht tregojnë se çka mendojnë, atëherë prindërit do t'ua ndalojnë ose do t'ua kufizojnë disa gjëra.	Besimi ndërmjet prindërve dhe fëmijëve rritet duke e shfaqur sinqerisht mendimin, ndërsa ndalimet dhe kufizimet i mbrojnë fëmijët nga rreziqet.
5. Fëmijët duhet t'i dëgjojnë prindërit, sepse ata kanë më shumë përvojë dhe janë më të mençur, andaj mendimin e tyre duhet ta mbajnë për vete ose t'ua shfaqin moshatarëve të tyre.	Edhe përkundër asaj se prindërit kanë më shumë përvojë, fëmijët duhet të mësohen të formojnë mendim të tyre dhe atë ta shprehin, sepse secili e këndin e tij të shikimit të gjërave.

Fletë pune për nxënësit I-6.3: Kush të vendosë?

1. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim? Kush duhet të vendosë se a do të qëndrojë ai në shtëpi vetë derisa të rriturit shkojnë të blejnë?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

5 vjeç

10 vjeç

15 vjeç

2. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim se a do të mbetet fëmija në kontakt me prindërit e tij nëse ata shkurorëzohen?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

4 vjeç

9 vjeç

17 vjeç

3. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim se a duhet të veshë fëmija mantel të bardhë për shi nëse del jashtë kur bie shi?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

3 vjeç

9 vjeç

12 vjeç

4. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim se a do të bëhet fëmija vegjetarian?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

4 vjeç

8 vjeç

13 vjeç

5. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim se mund të pinë duhan prindërit?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

6 vjeç

11 vjeç

17 vjeç

6. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim a mund të qëndrojë fëmija jashtë deri në mesnatë?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

9 vjeç

12 vjeç

16 vjeç

7. A duhet të dëgjohet mendimi i fëmijës kur duhet të merret vendim se a do të vendoset fëmijë në jetimore?

Kush duhet të vendosë kur fëmija është:

4 vjeç

10 vjeç

15 vjeç



1. Gjithë kohën tënde të lirë e shfrytëzon duke shikuar televizion. Lëshoje një rreth.

2. Kur ke kohë të lirë, prindërit të japin për detyrë të kujdesesh për motrat dhe vëllezërit me të vegjël. Ktheu dy fusha prapa.

3. Pasi t'i bësh detyrat e shtëpisë, luan me shokët. Shko tre fusha përpara.

4. Vazhdimisht mëson dhe i bën detyrat e shtëpisë. Nuk ke kohë asnjë minutë. Lëshoje një rreth.

5. Shteti ka vendosur që viti shkollor të zgjatë 12 muaj dhe nuk ka as pushim dimëror, as pushim veror. Të gjithë lojtarët kthehen tre fusha prapa.

6. Drejtori i shkollës ka urdhëruar që të mësohet edhe të shtunën dhe të dielën. Të gjithë lojtarët kthehen dy fusha prapa.

7. Në kohën e lirë lexon libër dhe thjesht harron edhe të hash nga fakti se libri është interesant. Shko tre fusha përpara!

8. Shokëve u dhuron për ditëlindje hallka ose stoli të punuara në dorë , të cilat ti i bën vetë në kohën e lirë. Hidhe zarin përsëri.

9. Ushtron karate tre herë në javë. Shko tre fusha përpara.

10. Një pjesë të kohës së lirë e shfrytëzon që të mësoh gjuhë të huaj. Hidhe zarin përsëri.

11. Mezi pret ta kryesh detyrën e shtëpisë që të luash në kompjuter. Asgjë tjetër nuk të intereson dhe më orë të tëra luan aty. Lëshoje një rreth!


12. Gjatë fundjavave shpesh viziton shfaqje teatrale ose filma në kinema, koncerte dhe ekspozita. Hidhe zarin përsëri.

13. Çdo pasdite së bashku me shokët e ndërtoni një shtëpizë. Shko tre fusha përpara.

14. Në kohën e lirë shikon emisione të popullarizuara shkencore (për kafshë, gjithësi, artistë). Hidhe zarin përsëri.

15. Sapo të kthehesh nga shkolla, patjetër duhet të shkosh në treg dhe të shesësh. Aspak nuk ke kohë për të luajtur. Lëshoje një rreth!

Fletë pune për nxënësit I-7.1b: Kartela: shkallë dhe gjarpërinj



Fletë pune për nxënësit II-1.2: Ndjekja pas autografeve

1.Gjeni dy nxënës që dëshirojnë të këndojnë derisa bëjnë dush!

2.Gjeni tre nxënë me ngjyrë të njëjtë në flokëve sikur ti!

3.Gjejeni një nxënës që dëshiron shumë të hajë spinaq!

4.Gjeji dy nxënës që janë më të gjatë se ti ose dy që janë më të shkurtër se ti!

5.Gjeji tre nxënës të cilët dëshirojnë shumë të pinë çaj me 3 lugë sheqer!

6.Gjeje një nxënës i cili i do gjarpërinjtë!

7.Gjeji tre nxënës të cilët dëshirojnë filma të vizatuar!


8.Gjeji dy persona të cilët dëshirojnë shumë të lexojnë libra!

Fletë pune për nxënësit II-1.3: Ndeshje me meteoritin


Ndeshje me meteoritin


Kthehesh në shtëpi i/e lodhur nga blerja e dhuratave për vitin e ri 2120. E kyç holobimin pikërisht në momentin kur programi ndërpritet për shkak të lajmeve të jashtëzakonshme. Spikeri i frikësuar e përcjell lajmin se për diçka më pak se gjysmë orë në Tokë pritet goditje e tmerrshme e një meteoriti të madh. Meteoriti është aq i madh sa që mund të shkatërrojë gjithçka në Tokë. Për fat të mirë, ky është viti 2120, andaj njerëzit pa problem mund ta braktisin Tokën. Spikeri tregon se tashmë është organizuar evakuimi i popullatës në planetin tjetër të pabanuar dhe secili udhëtar mund të marrë me vete nga gjashtë gjëra.

Secili i ka 3 minuta që të mendojë
dhe të zgjedhë se cilat gjashtë gjëra do t'i marrë me vete.



Fletë pune për nxënësit II-1.4: Gjëja e rëndësishme në fotografi





Detyrë shtëpie- Mirsadi ishte sëmurë dhe ai e dinte se të nesërmen nuk do të mund të shkonte në shkollë. Ai ishte i brengosur për shkak se ishte shumë me rëndësi që para fundit të gjysmëvjetorit ta dorëzojë detyrën e shtëpisë të cilën e kishte punuar gjatë tërë muajit. Mendonte si ta dërgojë në shkollë. Iu kujtua se Petari nga ndërtesa fqinje mësonte në klasën afër klasës së tij. Mirsadi nuk e njihte aq mirë, por megjithatë vendosi ta lus t'i ndihmojë – t'ia dërgojë detyrën e shtëpisë në shkollë dhe t'ia dorëzojë arsimtares. Kur shkoi te ai, Petari në fillim u habit. E pyeti: “Pse ka ardhur pikërisht te unë e nuk ka shkuar te dikush tjetër”. Mirsadi i tha se para disa ditëve e ka parë si i ndihmon një gjyshes ta kalojë rrugën. “Kur të pashë ashtu, mendova se duhet të jesh shok i mirë, andaj erdha te ti”. Petari vetëm u buzëqesh, e mori detyrën e shtëpisë dhe i tha: “Mos u brengos, do ta dërgoj detyrën e shtëpisë në shkollë”.

A t'i them – Samiri është nxënësi i ri në shkollën “Dielli”. Ai erdhi nga një qytet tjetër. Në ditët e para nuk bisedonte shumë me nxënësit e klasës, por pastaj filloi të shoqërohet gjithnjë e më shumë. Qysh në javën e parë, Nadica iu afrua dhe e pyeti për shkollën paraprake, si ka qenë atje, a i mungojnë shokët e të ngjashme. Derisa fliste Nadica, Samiri e vërejti si i vinte erë e keqe nga goja. Ra në dilemë, a ti thotë a mos t'i thotë. Në fund megjithatë ia përmendi. Nadica nuk tha asgjë. Samiri nuk e dinte a ka vepruar mirë ose jo. Ka mund të më jetë shoqe, mendoi ai, e kështu asgjë nuk doli. Të nesërmen, Nadica përsëri iu afrua. “Më fal për dje”, i tha, “u turpërova”. “Kur shkova në shtëpi, bisedova me motrën time dhe ajo më ndihmoi ta kuptoj se ti vetëm ke dashur të më ndihmosh”.

Bojani i ofenduar – Bojani dhe Armini nuk janë më shokë, edhe pse deri para do kohë kishin shoqëri të shkëlqyeshme. Një ditë ndodhi diçka që e hidhëroi shumë Bojanin dhe ai refuzoi të shoqërohet edhe më tej me Arminin. Në fakt, para se të hyjë në klasë e dëgjoi emrin e vet. E dalloj zërin e Arminit i cili fliste për të. Ndërkaq atë që e dëgjoi të flitej nuk i pëlqeu aspak. Armini u tregonte disa nxënësve tjerë se Bojani është person shumë i çuditshëm, se është pak torllak, kur ec shkon duke u lëkundur dhe nuk di të vozisë biçikletë. “Të falënderim që më tregove se çka mendon për mua”, tha Bojani dyke hyrë në klasë. Armini nuk dinte ç'të thoshte. Bojani e shikoi në sy dhe i tha se nuk dëshiron më të shoqërohet me të.

Ndihmë përmes telefonit – Arsimtarja e qortoi Ajserin sepse nuk e kishte detyrën e shtëpisë. Ajseri pohonte se e kishte bërë, por e kishte harruar në shtëpi. Arsimtarja dyshonte. Atëherë u paraqit Snezhana dhe i tregoi arsimtares se natën e kaluar ajo i është paraqitur Ajserit, sepse nuk e kishte pasur të qartë një detyrë, ndërsa Ajseri i kishte ndihmuar si ta zgjidhë detyrën. Arsimtarja e shikoi Ajserin në sy, kurse ajo e lëvizi kokën në shenjë konfirmimi.

Pëllumbi dhe thnegla¹ – Një thnegël, duke shkuar në lum për të pirë ujë, ra në të dhe e mori uji. Kur e pa atë pëllumbi, i erdhi keq dhe ia hodhi një degë të vogël. Duke u mbajtur në të thnegla doli në breg. Menjëherë pas kësaj, thnegla e pa një njëri me pushke si merr nishan në drejtim të pëllumbit. Prandaj ajo e kafshoi njeriun në këmbë ashtu që ai e huqi cakun. Në këtë mënyrë ia shpëtoi jetën pëllumbit.

Fletë punë për nxënësit II-3.1: Sekrete të mira dhe të këqija

Shoku ta beson një sekret dhe të thotë të mos i tregosh askujt. A është sekreti i mirë ose i keq?

I MIRË	SEKRETI	I KEQ
	I ka dhënë motrës më të vogël të pijë cigare.	
	Ia ka shkruar një vjershë simpatisë së tij.	
	Ia ka blerë një dhuratë shoqes për ditëlindje.	
	Herë pas herë vjedh nëpër shitore.	
	Kur ka qenë i vogël e ka kafshuar qeni.	
	Nuk dëgjon mirë më veshin e majtë.	
	Është lënduar në rrahje me një fëmijë tjetër, ndërsa në shtëpi ka thënë se ka rënë nga biçikleta.	
	Babai i tij nuk jeton me të dhe me nënën e tij.	
	Duke shëtitur, i ka thyer syzat duke i rënë shenjën së komunikacionit.	
	Cila është simpatia e shokut të përbashkët.	
	E ka thyer dritaren, ndërsa në vend të tij e kanë zënë një fëmijë tjetër.	
	Ia ka fshehur gomën e shokut që të mos mund të ketë me çka të fshijë gjatë hartimit me shkrim.	

Fletë pune për nxënësit II-4.1: Disa gënjeshtra

1. Duke shëtitur nëpër shitore me babin e saj, Liza e vërejti një çantë shkollore shumë të bukur. Ajo e luti të atin t'ia blejë. Ai i tha se ende mund ta përdorë çantën e vjetër dhe se nuk ka nevojë të blejë çantë të re. Lizës i shkoi ndër mend të thotë se çanta e saj është e grisur në pjesën e poshtme dhe për atë shkak i bien lapsat, stilografët dhe gjërat e tjera. Kuptohet se çanta nuk ishte e grisur. Liza gënjeu. Pse gënjen ajo?

- a) Për shkak se është fëmijë i keq
- b) Dëshiron të marrë diçka për të cilën e di se nuk i takon
- c) Shumë i do çantat

2. Në orën e gjuhës amtare, duke folur për atë se është mirë të ndahen gjërat me më të afërmit, Ledoni shpjegon se gjithnjë kur ka diçka për të ngrënë, e ndan me vëllain e tij më të vogël. Mirëpo, ai kurrë nuk dëshiron t'ia japë gjërat e veta vëllait të vet. Pse gënjen Ledoni?

- a) Për shkak se është gënjeshtar
- b) Dëshiron që të tjerët të kenë mendim të mirë për të
- c) Që të marrë notë kaluese

3. Gjatë pushimit Hana iu afrua Deas dhe i pëshpëriti: „A e pe frizurën e re të Nenës. Më e shëmtuar nuk mund të jetë”. Pastaj u largua. Nena i doli Deas përpara. “Çka të pëshpëriti Hana?”, e pyeti ajo. “Më tha se sot do të kemi test në lëndën e matematikës”, e gënjeu Dea. Pse gënjeu Dea?


- a) Ajo gjithnjë gënjen
- b) Konsideron se në këtë rast e vërteta është e hidhur
- c) Nenën nuk e ka shoqe të vërtetë

4. Duke luajtur me topin e tenisit, Vuki e theu dritaren e vitrinës. Prandaj u frikësua se çka do t'i thonë prindërit. Kur erdhën ata në shtëpi, Vuki u tha se i ka zënë këmba në tepison dhe i ka rënë qelqi me libër. Vuki gënjen. Pse gënjen ai?

- a) Frikohet se do ta dënojnë
- b) Edhe ashtu gjithçka u thotë, ata i besojnë
- c) Dëshiron të blejë një vitrinë të re në shtëpi

SI MË NDIHMOJNË NË SHTËPI?		
SI DNIHMOJ NË SHTËPI?		

SI MË NDIHMOJNË NË SHKOLLË?	
SI NDIHMOJ NË SHKOLLË?	



Fletë pune për nxënësit II-5.2b: Miu




Foto 1



Foto 2




Foto 3

Fletë pune për nxënësit II-5.3: Lojë me nevoja të veçanta



nuk sheh mirë

nuk dëgjon mirë

**nuk mund ta përdorë
dorën e majtë**

**nuk mund ta lëvizë
këmbën e djathtë**

**nuk dëshiron të luajë
me fëmijë të tjerë**

**nuk kupton se çka
thuhet**

**shumë ngadalë i
shqipton fjalët**

Fletë pune për nxënësit II-6.1: 4 situata, 4 gabime

1. Igori e reciton një vjershë para klasës. Kur e mbaron, niset drejt vendit në bankën e tretë. Ai e vëren Milen sesi e shikon në sy, ndërsa në të njëjtën kohë e vëren sesi Mileja e shtrin këmbën e majtë. Igori nuk ka kohë të reagojë – ngatërrohet në këmbën e tij dhe rrëzohet. Të gjithë qeshen. Igori ngrihet i drejtohet Miles më zë të lartë: “Pse ma vure këmbën?” Mileja, duke e shikuar arsimtaren, i përgjigjet: “Nuk të rrëzova unë. Vetë u ngatërrove te banka”.

A është veprimi i Miles i qëllimshëm?
Cilat janë pasojat e veprimit të tij?
Si mund të përmirësohet gabimi?

2. Posa filloi pushimi i madh, Deni dëshiron të dalë jashtë për të blerë diçka për të ngrënë. Vrapon drejt derës dhe posa arrin aty, Sejhani e cili nuk e sheh që Deni është pas shpinës së saj, ia mbyll derën në fytyrë dhe ai goditet në derë. “Sejhaaaaan, ke kujdes kur ta mbyllësh derën”, klithi ai. Sejhani, iu afrohet dhe i thotë: “Më fal, nuk të vërejta fare. Vërtetë më vjen keq që u lëndove në derë”.

A është i qëllimshëm veprimi i Sejhanit?
Cilat janë pasojat e veprimit të saj?
Si mund të përmirësohet gabimi?

3. Boki vjen në shkollë, por e kupton se ka arritur shumë herët. Ditën e kaluar për shkak se ka qenë i sëmurë ai nuk kishte qenë në shkollë. Arsimtari u kishte thënë nxënësve që për ditën e sotme të vijnë 2 orë më vonë. Ai i kishte thënë Farukut, i cili jeton afër Bokit, që t’ia përcjellë atij këtë informacion, por ai nuk i kishte treguar. Kur erdhi Faruku, filloi të bërtasë: “Oh, oh, paskam harruar të të tregoj se sot jemi më vonë në shkollë”. “Më fal”. Boki është i hidhëruar dhe nuk flet asgjë.

A është i qëllimshëm veprimi i Farukut (që nuk e informoi për ndërrimin e orarit)?
Cilat janë pasojat e veprimit të tij?
Si mund të përmirësohet gabimi?

4. Më shumë shoqe të mëhallës, luajnë futboll para ndërtesës. Një banues i katit të parë ua tërheq vërejtjen se ai vend nuk është për të luajtur futboll. Ata nuk ia varin veshin kësaj vërejtje. Për një moment, Nesa e gjuan topin dhe ai bie në dritaren e banuesit të katit të parë. Kështu xhami thyhet.

A është i qëllimshëm veprimi i Nesës?
Cilat janë pasojat e veprimit të saj?
Si mund të përmirësohet gabimi?

**Arsimtarja e ka dënuar
Donën për diçka që Dona konsideron
se është fajtor Darkoja.**

**Luani, ashtu siç e do rendi,
pret në radhë për të blerë sandviç,
por papritmas dy fëmijë nga klasat
më të larta shtyhen (futen) pa rend.**

**Sejhani fjaloset me të ëmën e saj
për shkak se nuk e lëshon të dalë me shoqet
para se ta rregullojë dhomën, ndërsa për ta
rregulluar atë asaj i duhen së paku dy orë
punë.**



akuzë (fajësim)	
kërcënim	
ofendim	
kritikë	
nënçmim	
poshtërim	
përqeshje	
bërtitje/çirrje	
vënia e emrave ofendues	
sharje	
bërja me gisht /m edorë	
bërja e grimasave (shtrembërim)	
shtyrje	
goditje	
shuplakë	
gjuajte	
hedhje	

Fletë pune për nxënësit II-7.3a: Kontrollimi i hidhërimit - 1

- » Numërim deri më 10: Përmes numërimit dhe frymëmarrjes së thellë shumë shpejt qetësohemi. Me këtë fitohet kohë që ta rikthejmë kontrollin mbi hidhërimin tonë.



Kur do të mund ta shfrytëzoja?

[illegible]

- » Prolongim: Zënka për shkak të situatës së shkaktuar nga hidhërimi lihet për më vonë. Në këtë mënyrë fitohet kohë për kthimin e vetëkontrollit.



Kur do të mund ta shfrytëzoja?

[illegible]

- » Shkrimi i porosive: Mundëson të zbulohet problemi dhe ndihmon në rregullimin e ndjenjave. Fitohet kohë për të menduar për mënyrën e ballafaqimit me problemin. Mund të shkruhen gjëra për të cilat në të ardhmen do t'ju vijë keq – prandaj duhet të asgjësohet ai shkrim që të mos mund të shkaktojë dëm më të madh.



Kur do të mund ta shfrytëzoja?

[illegible]

» Përfytyrimi: shpeshherë njerëzit reagojnë si “pllakë e prishur e gramafonit” – automatikisht i përsërisin gjërat e njëjta të këqija kur të ballafaqohen me ndonjë problem. Shprehia e këtillë mund të ndërpritet duke e imagjinuar një situatë konflikti si nën shirit filmik: shiriti ndërpritet aty ku fillon të reagohet “sipas avazit të vjetër”, pastaj paramendohet një mënyrë tjetër për të vazhduar më tej (me çka do të shprehej gatishmëri që bashkërisht të punohet për zgjidhjen e problemit).




Kur do të mund ta shfrytëzoja?


[illegible]

Fletë pune për nxënësit II-8.1: Shprehjet e fytyrës


Si duket ...




Te dentisti




Ka shkruar
hartimin më të mirë




Dikush ia ka
vjedhur atletet




Dita e fundit
në shkollë




E vetmuar në shtëpi
shikon film të tmerrshëm




I ka ngordhur
papagalli i shtëpisë




U ka ndihmuar
prindërve



Nuk ia kanë plotësuar
premtimin



Shikon si
vjell dikush



E kanë zënë
në renë

Fletë pune për nxënësit II-8.4a: Si dëgjoj në mënyrë aktive



Ndërprite, ndërhyri në fjalë kur flet për diçka që nuk është e rëndësishme.

Thuaji se ka vepruar si torollak/e.

Kritikojë, thuaji se nuk vepron si ai/ajo.

Ndryshojë temën...p.sh. "A të të tregoj se çfarë filmi kam shikuar dje".

Thuaji se ai nuk bëhet njeri, se është shumë i/e ngathët .

Kërcënoje se nuk dëshiron ta dëgjosh si flet.

Ofroja ndonjë përgjigje, çka është dashur të bëjë, e çka nuk është dashur të bëjë.

Tregoi përvojat personale..."Eh sikur ta dish se çka më ka ngjarë mua, kjo e jotja asgjë nuk është"...

Vazhdimisht lëvize kokën në shenjë të mirënjohjes.

Shikojë në sy dhe buzëqesh.

Afroju sa më shumë kah ai ashtu që do të anosh kah ai.

Mbështetu në karrige dhe lëvize shikimin poshtë-lart.

Vazhdimisht merru me rrobat, këpucët, luaj me lidhëset.

Parashtro pyetje të tipit "Nëse të kuptova drejt, po thua që..."
dhe përsërite se çka ke dëgjuar që të ka thënë.

Paramendoje atë që ta tregon sikur të të kishte ndodhur edhe ty
(futu në lëkurën e bashkëbiseduesit).

Parashtro pyetje të tipit:
"Çka ndodhi pastaj? A mund të më tregosh më tepër për..."



NDËRPRERJE, NDËRHYRJE.

VLERËSIM.

KRITIKË.

NDËRRIM I TEMËS.



**NËNÇMIM,
PËRQESHJE.**

KËRCËNIM.

**KËSHILLIM, NË VEND SE TË DËGJOSH SE ÇKA
DËSHIRON TË TREGOJË.**

**SHPREHJE TË PËRVOJAVE PERSONALE NË
VEND SE TË DËGJOSH SE ÇKA DËSHIRON TË TË
TREGOJË.**



LËVIZJA E KOKËS NË SHENJË MIRATIMI.

SHIKIM NË SY DHE BUZËQESHJE.

ANIM KAH AI QË FLET.

**MBËSHTETJE NË KARRIGE DHE LËVIZJE E
SHIKIMIT POSHTË E LART.**




**MARRJA ME RROBAT DHE KËPUCËT DERISA
TJETRI FLET.**

**PARASHTRIMI I PYETJEVE PËR PARAFRAZIM
(PËRSËRITJE E SHKURTËR E ASAJ QË ËSHTË
THËNË ME FJALË TË TJERA).**

**HYRJA NË LËKURËN E BASHKËBISEDUESIT
(shfaqja e mirëkuptimit për atë që i ka
ndodhur atij).**

PARASHTRIMI I PYETJEVE SHPJEGUESE.

Fletë pune për nxënësit II-8.5a: Parafrazimi 1



Shembull:

"Babai im është njëri vetjak dhe i pamëshirshëm, i cili aspak nuk kujdeset për mua. Nuk më lejon të shkojë në ekskursion me shokët, andaj me të drejtë e urrej."



Fletë pune për nxënësit II-8.5b: Parafrazimi 2

Qeni

Naumi: Kur mu vërsul qeni, mu ndal zemra. Mendova se po vdes. Vërtetë ky fqinji është njëri i pafytyrë. As maskë nuk i vë qenit. Do ta shohë ai, do ta paraqes në polici ose do t'ia helmoj qenin.

Nëse të kuptova mirë...
ti _____
për shkak se _____

Vonimi

Mirela: Më bën të çmendem. Vazhdimisht e pres, për gjithçka që merremi vesh, vëllai im nuk do të vijë në kohë dhe gjithnjë e gjen nga një superarsyetim.

Nëse të kuptova mirë...
ti _____
për shkak se _____

Veshje

Azra: Motra ime sillet ndaj meje sikur të jem ndonjë vegël. Gjithnjë i vesh rrobat e mia pa më pyetur fare. Sikur unë të mos ekzistoj. Këtë nuk e kam pritur nga motra ime.

Nëse të kuptova mirë...
ti _____
për shkak se _____

Celulari

Sibeli: Gati sa do ta rrihja Vilmën kur e pashë se po m'i lexon porositë e celularit para të tjerëve. Si guxon të ma prekë telefonin?!!

Nëse të kuptova mirë...
ti _____
për shkak se _____

Na ishin njëherë gjashtë mendarë të verbër të cilët jetonin në të njëjtin qytet. Një ditë, nga ndonjë vend e sollën një elefant në qytet. Gjashtë mendarët deshën të dinë sesi duket elefanti. Meqë ishin të verbër, iu afruan dhe filluan ta prekin.

Mendari i parë e preku veshin e madh të lëmuar të elefantit dhe pasi ndjeu se si lëvizte ngadalë andej-këndeje, tha:

“Elefanti është si erashka”.

Mendari i dytë ia preku këmbën elefantit dhe brohoriti:

“Elefanti është si druri!”

Mendari i tretë e preku bishtin e elefantit.

“Asnjëri nuk keni të drejtë” - tha ai dhe vazhdoi - “elefanti është si litari”.

Mendari i katërt e kapi feçkën e elefantit dhe klithi:


“Të gjithë gaboni! Elefanti është si gjarpëri!”

Mendari i pestë e preku majën e dhëmbit të madh e të mprehtë të kafshës dhe tha: “Elefanti është si shtiza!”


“Jo, jo! Ju s’dini gjë! Elefanti është si muri i lartë!” - bërtiti mendari i gjashtë - “, pasi e kishte prekur njërën anë të trupit të elefantit.


“Erashka!”, “Druri!”, “Litari!”, “Gjarpëri!”, “Shtiza!”, “Muri!”, me orë të tëra u munduan t’i mbushin mendjen njëri - tjetrit gjashtë mendarët dhe asnjëherë nuk u pajtuan se si dukej elefanti.

Përrallë e vjetër indiane














**nevoja për
VETËSENDERËTIM**

*nevoja për të arritur
gjithçka që mund arrihet*

nevoja për NDERIM

*nevoja për t'u ndier i vlefshëm, i zoti dhe i çmuar,
për të tërhequr vëmendjen, për të fituar mirënjohje
dhe për të qenë i nderuar*

nevoja për DASHURI dhe MIQËSI

*nevoja për t'ia falur e për t'ia pranuar dashurinë dikujt
dhe për t'i takuar një grupi*

nevoja për SIGURI

nevoja për siguri, për trajtim të drejtë dhe për besim te njerëzit

nevoja për JETË

nevoja për ajër, ushqim, ujë, vendbanim, ndihmë mjekësore, pushim dhe rekreim

Fletë pune për nxënësit II-10.3e: Nevoja - situata

Situata 1

Dime ka shumë punë të mundimshme. Kur kthehet në shtëpi, shtrihet dhe fle një deri në dy orë që pastaj të mund të vozisë në mbrëmje taksi. Një pasdite sapo kishte rënë dhe po rrëshqiste në gjumë, e zgjoi një zhurmë e madhe nga jashtë. Fëmijët e ndërtesës ngjyrë portokalli ishin mbledhur në rrugën pranë ndërtesës së tij dhe po luanin futboll. Bërtitnin, trokitnin dhe Dime s'kishte fare mundësi të flejë si ditët e tjera. Ai u nervozua shumë. Doli jashtë dhe fluturoi drejt topit. E mori në dorë dhe bërtiti: "A e dini ju fëmijë të paedukatë se ku luhet futboll. A këtu gjetët të luani?!" Pastaj u kthye dhe me top në dorë u nis kah podrumi. "Axha Dime, axha Dime!", thirrën fëmijët. Por, ai as që i shikoi.

Situata 2

Ishte një ditë e bukur me diell. Zana dhe motra e saj vendosën të shëtisin në park. Ta dyja e donin parkun për shkak të natyrës, gjelbërimit, liqenit, por edhe për shkak të vozitjes me veturat e vogla në pjesën argëtuese të parkut. Megjithatë atë ditë nuk kaluan mirë. Derisa po qëndronin ulur në një karrige, papritmas prej diku u paraqit një qen dhe po u afrohej duke lehur. Zana u frikësua. "Joooo", bërtiti, duke u përkulur të marrë ndonjë gurë që të mbrohet. Kur e pa pronari i qenit, që po vinte drejt tyre, se çka po bënte, i bërtiti: "Mos me gurë, ti a je normale?!" "A je ti normal?!", ia ktheu Zana. "Pse e ke lëshuar qenin?!" dhe kështu filluan të grinden.

Situata 3

Ana i ka dhjetë vjet dhe mendon se askush nuk i kushton vëmendje asaj. Ajo e di se prindërit e duan, por i duket se gjithë vëmendja është e orientuar drejt vëllait të vogël, Filipit. Babai i saj, që gjithë ditën është në punë, kur kthehet ka kohë të luajë vetëm me të. Edhe nëna kujdeset vetëm për të – e vesh, e ushqen dhe kujdeset që askush mos ta shqetësojë atë derisa fle. Kur kthehet Ana nga shkolla, nëna e saj bile kërkon që ajo t'i ndihmojë në punët rreth Filipit – ta mbajë që nëna t'i përgatitë ushqim ose që t'ia lajë teshat.

Një ditë, kur Ana u kthye nga shkolla dhe dëshironte t'i lavdërohet nënës së saj se ka marrë pesëshe në matematikë, nëna nuk kishte kohë që ta dëgjojë. Menjëherë e urdhëroi që të kujdeset për Filipin derisa ajo të shkojë në shitore të blejë diçka. Atëherë Ana vendosi t'i hakmerret Filipit. Derisa vëllai i saj po flinte qetë, ajo i bërtiti shumë fortë në vesh. Ai u frikësua dhe filloi të qajë. Ndërkaq Ana u përpoq ta qetësojë, por nuk ia doli. Kur u kthye nëna, edhe asaj iu deshën njëzet minuta të tërë që ta qetësojë.

Situata 4

Eva e pëlqen shumë matematikën. Ajo mundohet të jetë aktive në orë, rregullisht i bën detyrat, madje i zgjidh edhe disa detyra të revista matematikore. Por, arsimtarja sikur fare nuk e vëren. Ajo vazhdon me këmbëngulje ta lavdërojë Esmën. "Po, Esma", "Bravo Esma", "Hajde Esma" dhe vetëm Esma. Andaj kur e ftoi dje arsimtarja Evën dhe i tha se dëshiron që ajo të shkojë në gara të matematikës, ajo ia ktheu ftohtë se nuk dëshiron të marrë pjesë në gara. "Si nuk dëshiron?!", u habit arsimtarja. "Unë të them se ti do të shkosh." "Ndërsa unë them se nuk do të shkoj, le të shkojë Esma, ajo nxënësja e dashur", ia ktheu Eva.

Situata 5

Mona tashmë një vit ushtron karate. Në fakt në fillim nuk i shkonte shumë mirë. Njëherë trajneri i saj i tha se nuk bëhet karateiste prej saj. Por, kjo sikur e hidhëroi Monën. Ajo ishte shumë e vendosur që të bëhet karateiste, madje karateistja më e mirë. Mona ushtronte shumë dhe me kalimin e kohës trajneri e ndërroi mendimin për të. Ndërkaq Mona ishte shumë e lumtur. Ajo me pa durim e priste turneun që do të mbahej në një qytet tjetër që të dëshmojë se sa ka përparuar. Por, pikërisht atëherë, disa ditë para turneut, kur nëna e saj e kuptoi se duhet ta humbë gjithë vikendin, i tha Monës se nuk do ta lejojë të marrë pjesë në turne. "Ke shumë mësimë, tash është fundi i vitit, e ke patjetër të kujdesesh që gjithçka të jetë në rregull", i tha nëna e saj. "Por, nënë, unë a kot kam ushtruar tërë vitin?!", iu përgjigj Mona. "Nëse nuk më lejon ti, unë vetë do të shkoj", shtoi ajo".

Fletë pune për nxënësit II-10.4a: Burimet e konflikteve

RESURSET E KUFIZUARA (kohë, para, pronë)	NEVOJAT E PAPLOTËSUARA (biologjike, psikologjike)	VLERAT E NDRYSHME (bindja, përparësitë, principet))
paraqesin shkak për konfliktin kur diçka është e kufizuar, kur nuk ekziston në sasinë e duhur. Për shembull: I biri dëshiron t'i blejnë jakne, ndërsa nëna nuk ka kohë ose nuk ka të holla. Ose: është një lodër me të cilën dëshirojnë njëherazi të luajnë edhe vëllai edhe motra.	për shembull: nëse motra e pi ujin gjatë rrugës dhe vëllai mbetet i etur ose nëse dikë nga shokët nuk e ftojnë në aheng etj.	paraqiten si shkak për konflikt atëherë kur dy persona i japin vlerë të ndryshme të njëjtës gjë ose kur për njërin është më me rëndësi diçka, ndërsa për tjetrin diçka tjetër. P.sh.: gruaja dëshiron të shkojë në pushim në det, ndërsa burri e urren detin dhe dëshiron të shkojë në mal.



Dy motra grinden se kush ta veshë një bluzë.


Nxënësit kërkojnë të mësojnë gjuhë të huaj në mënyrë bashkëkohore, përmes kompjuterëve, ndërsa arsimtari reagon duke thënë se kompjuterët janë për lojë dhe argëtime të tjera, e jo për mësim.

Dy arsimtarë grinden për notën e Bashkimit. Njëri thotë se ai duhet të ketë 5, sepse i ati i tij është kolegë më atë, ndërsa arsimtari tjetër thotë se 5 lihet vetëm për dituri.

Damiri refuzon të marrë pjesë në bend me shokët, sepse ditën e kaluar ata nuk e kanë ftuar në kinema.

Lejla dhe Lila grinden se cila do të ulet në ulësen e përparme të veturës.

Burri dhe gruaja grinden se a do ta shikojnë serinë humoristike në Kanal 7 apo një seri tjetër humoristike në kanal 8.




Ç'ËSHTË ME PËRFUNDIMIN (ZGJIDHJEN) E KONFLIKTIT ?	Ç'ËSHTË ME NDJENJAT E TË RËNIT PAS TË REAGUARIT?	Ç'ËSHTË ME MARRËDHËNIET NË MES TË DYVE NË ARDHMËRI?
--	---	--




KUNDËRSHTIMI



Ç'ËSHTË ME PËRFUNDIMIN (ZGJIDHJEN) E KONFLIKTIT ?	Ç'ËSHTË ME NDJENJAT E TË RËNIT PAS TË REAGUARIT?	Ç'ËSHTË ME MARRËDHËNIET NË MES TË DYVE NË ARDHMËRI?
--	---	--



BISEDIMI



“UNË MESAZHI”

Arsimtarja i vë Oliverit njësh në matematikë, sepse ai është i padisiplinuar në orë.

Oliveri i drejtohet arsimtares:

NDJEHEM i ofenduar

KUR JU me vëni njësh në matematikë pa më pyetur.

JU KISHA LUTUR që para se të më notoni, të më pyetni, e nëse vlerësoni se edhe më tej jam i padisiplinuar, mund të ndërmerrni masa adekuate disiplinore.



Marija i kërkon Darkos që t'ia kthejë fletoren të cilën ia ka huazuar, ndërsa Darkoja ia kthen të grisur, duke u arsyetuar se atë e ka bërë motra e tij më e vogël.



Marija i drejtohet Darkos duke shfrytëzuar "UNË"-MESAZH:

Ndjehem _____
(emërtohet ndjenja e pakëndshme)

kur ti/ju _____

(përshkruhet veprimi problematik)

do të doja/ju kisha lutur _____

(ofrohet zgjidhje)

Learti i qetë pret që së pari
të zbresin udhëtarët nga autobusi
e pastaj të hipi vetë, kur një fëmijë
e shtyn që të ngjitet para tij.



Learti i
drejtohet fëmijës
duke shfrytëzuar
"UNË"-MESAZH:

Ndjehem _____
(emërtohet ndjenja e pakëndshme)

kur ti/ju _____

(përshkruhet veprimi problematik)

do të doja/ju kisha lutur _____

(ofrohet zgjidhje)

Babai i kanoset Zanës se do ta ndërpresë programin në Tv nëse ajo vazhdon ta shohë Tv serialin e preferuar, duke refuzuar të shkojë deri në shitore për bukë.



Zana i drejtohet babait duke shfrytëzuar "UNË"-MESAZH:

Ndjehem _____
(emërtohet ndjenja e pakëndshme)

kur ti/ju _____

(përshkruhet veprimi problematik)

do të doja/ju kisha lutur _____

(ofrohet zgjidhje)




Neni 19.

Fëmijët nuk lejohet të lëndohen.



Neni 9.

Fëmija ka të drejtë për prindër që do të kujdesen për të.



Neni 7.

Secili fëmijë ka të drejtë të emrit dhe të shtetësisë.



Neni 12.

Fëmija ka të drejtë të thotë se çka mendon për të gjitha punët që kanë lidhje me të.



Neni 15.

Fëmijët kanë të drejtë të shoqërohen.



Neni 42.

Secili fëmijë ka të drejtë t'i dijë të drejtat e tij.



Neni 32.

Fëmijët kanë të drejtë të mbrojtjes nga puna e rëndë.




Neni 31.

Fëmijët kanë të drejtë të luajnë.



Neni 23.

Fëmija që ka ndonjë hendikep ka të drejtë të trajtimit të veçantë dhe të drejtë që të rritet me fëmijët e tjerë.



Neni 38.

Fëmijët kanë të drejtë të mbrojtjes gjatë luftës.

Fletë pune për nxënësit III-1.2: Komplet prej gjashtë çifteve të të drejtave dhe përgjegjëse



Neni 12 Kam të drejtë që lirisht
ta shpreh mendimin tim




Neni 15 Kam të drejtë që lirisht
të shoqërohem me fëmijët e tjerë.






Neni 24 Kam të drejtë të më shërojnë
kur jam i sëmurë.



Neni 28 Kam të drejtë të shkoj në shkollë
dhe të arsimohem.





Neni 16 Kam të drejtë të privatësisë dhe të drejtë që ta ruaj nderin dhe autoritetin tim.



Neni 19 Kam të drejtë të mbrojtjes nga dhuna.





Kartela me të drejta 1

Prindërit e shoqes tënde këtë verë u ndanë, por ajo ende jeton me të dy prindërit e saj: një javë me njërin, e javën tjetër me prindin tjetër; kjo ka qenë zgjedhja e saj.
Shko përpara 2 fusha.

Neni 12,

Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës:

Fëmijët kanë të drejtë ta shprehin mendimin e tyre për atë që duhet të ndodhë kur prindërit marrin vendime që ata nuk i tangojnë, ndërsa mendimet e tyre duhet të merren në konsideratë.

Kartela me të drejta 2

Ti ke mësuar se nëse bie në ndonjë problem serioz, çdoherë mund të kërkossh ndihmë. Nëse paraqitesh në telefonin SOS dhe e shpjegon situatën, kompetentët do të mundësojnë kontakt me organizatat që përpiqen t'u ndihmojnë fëmijëve që janë braktisur ose që kanë probleme të tjera.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 19,

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës, keqpërdorimit dhe braktisjes:

Qeveritë duhet të sigurojnë që fëmijët të marrin kujdes adekuat dhe ata të mbrohen nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe braktisja prej prindërve të tyre ose nga cilido që kujdeset për ata.

Neni 36,

Mbrojtja nga format e tjera të eksploatimit:

Fëmijët duhet të jenë të mbrojtur nga çfarëdo aktiviteteve që mund ta dëmtojnë zhvillimin dhe mirëqenien e tyre.

Kartela me të drejta 3

Në klasën e shokut tënd fëmijët kanë vështirësi më të mëdha në mësim dhe marrin ndihmë plotësuese nga arsimtarët.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 23,

Fëmijët me pengesa në zhvillim:

Fëmijët që kanë çfarëdo pengesash në zhvillim duhet të kenë kujdes, mbështetje dhe arsim të veçantë që të mund të bëjnë jetë të plotë dhe të pavarur deri në kufijtë e tyre maksimalë.



Kartela me të drejta 4

Drejtoresha e shkollës tënd ka marrë vesh se disa fëmijë të lagjes tënde nuk vijnë në shkollë sepse prindërit e tyre nuk kanë mjaft të holla për libra. Drejtoresha kanë rënë në kontakt me ata dhe i ka bindur t'i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe ka marrë përsipër të sigurojë libra falas.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 28,

E drejta e shkollimit:

Fëmijët kanë të drejtë të shkollimit, gjegjësisht të drejtë që të shkojnë në shkollë... Shkolla fillore patjetër duhet të jetë falas.

Kartela me të drejta 5

Ti ke të drejtë t'i dish të drejtat tua njerëzore!

Shko përpara 4 fusha.

Neni 29,

Qëllimet e shkollimit:

Arsimi duhet ta zhvillojë deri në maksimum personalitetin e fëmijës, si dhe shkathtësitë dhe talentin e tij. Arsimi i përgatit fëmijët për jetë. Kjo duhet t'i inkurajojë fëmijët që t'i respektojnë prindërit e tyre, kulturën e tyre, si dhe kulturën dhe kombet e tjera.

Kartela me të drejta 6

Arsimtarëve të shkollës tënde nuk u lejohet t'i ndëshkojnë fizikisht fëmijët, e as t'i ofendojnë, madje edhe kur ata sillen keq.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 28,

E drejta e shkollimit:

Disiplina në shkollë duhet ta ketë parasysh dinjitetin njerëzor të secilit fëmijë; dhuna (fizike dhe mendore) nuk duhet të përdoret për disiplinim.

Kartela me të drejta 7

Në shkollën tënde ka shumë shkallë, por edhe lifte dhe pengesa, ashtu që njerëzit që nuk mund të ecin dhe përdorin qerre, mund të lëvizin gjithandej.

Shko përpara 3 fusha.

Neni 23,

Fëmijët me pengesa në zhvillim:

Fëmijët që kanë çfarëdo pengesash dhe hendikepi në zhvillim, duhet të kenë kujdes, mbështetje dhe arsim të veçantë që të mund të bëjnë jetë të plotë dhe të pavarur deri në kufijtë e tyre maksimalë.



Kartela me të drejta 8

Babai i shoqes tënde ka pësuar një fatkeqësi dhe një kohë të gjatë nuk do të mund të punojë. Derisa ai e merr veten, qeveria i ndihmon familjes që të ketë kenë mjaft të holla për ushqim dhe banesë.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 26,

Përdorimi i mbrojtjes sociale:

Shoqëria ku jeton fëmija duhet t'i mundësojë atij sigurim social (shkollim, kulturë, ushqim, shëndet dhe mirëqenie sociale) e cila do t'i ndihmojë të zhvillohet dhe të jetojë në kushte të mira. Qeveria duhet të sigurojë të holla plotësuese për fëmijët e familjeve që janë në gjendje të pavolitshme.

Kartela me të drejta 9

Ti mëson se të drejtat tuaja duhet të jenë të mbrojtura, madje edhe gjatë kohës së luftës dhe se ka marrëveshje të veçanta që të jesh i sigurt nëse ndodhë diçka e tillë.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 38,

Mbrojtja e fëmijëve në kushte të konfliktit luftarak:

Qeveritë nuk duhet të lejojnë që fëmijët nën moshën 15 vjeç të marrin pjesë në armatë ose të marrin pjesë në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë në veprime luftarake. Aq më tepër që fëmijët e zonave luftarake duhet të fitojnë mbrojtje të veçantë.

Kartela me të drejta 10

Në lagjen tënde ka biblioteka për fëmijë, revista, lojëra dhe emisione në TV, të bëra enkas për fëmijë, ashtu që ti të mund të dish dhe të kuptosh se çka ndodhë në botë.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 13,

Liria e të shprehurit dhe informimi:

Fëmijët kanë të drejtë të kërkojnë, të japin dhe të këmbejnë informacione në të gjitha format (art, formë të shkruar, në radio dhe në formë elektronike) derisa këto informacione nuk i dëmtojnë ata ose të tjerët.

Kartela me të drejta 11

Për fat të keq, duhet të shkosh në operacion. Por, e mira është që ti ke të drejtë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë, madje ke edhe të drejtë që njëri nga prindërit tuaj ose dikush që dëshiron ti të qëndrojë me ty spital.

Shko përpara 2 fusha.

Neni 24,

Mbrojtja shëndetësore dhe shërbimet shëndetësore:

Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje të mirë shëndetësore e cila nënkupton barna, spitale dhe mjekë kur jeni i sëmurë. Fëmijët gjithashtu kanë të drejtë për ujë të pijshëm, ushqim të shëndoshë dhe mjedis të pastër, që kështu të mbeten të shëndoshë. Vendet e pasura duhet t'u ndihmojnë vendeve të varfra që ta arrijnë këtë.

Fletë pune për nxënësit III-1.3b: Kartelat për lojë – kartelat ndëshkuese



Kartela ndëshkuese 1

Një shok/shoqe i yti/e ytja e ka humbur një këpucë, por nuk ka mjaft të holla që të blejë një palë këpucë. Shkolla thotë se aty nuk mund të hyjnë nxënës këmbëzbathur. Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 2

Prindërit e një fëmije me të cilin ti mëson janë romë. Familja e tyre ka problem të gjejë vend për banim, sepse njerëzit nuk i pranojnë dhe thonë “Ata janë të ndryshëm”. Shko prapa 4 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 3

Ti mëson se në disa vende ka fëmijë që janë të detyruar të luftojnë. Ata janë të uritur, të etur dhe shumë të frikësuar. Shko prapa në fushën 1.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 4

Një vajzë e shkollës tënde merret me manekieri. Ajo fiton shumë para dhe fotografia e saj gjendet nëpër gazeta. Por, ajo shpesh mungon nga orët dhe nuk ka kohë t'i bëjë detyrat e shtëpisë ose të luajë me miqtë. Ajo vërtet duket e lodhur. Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 5

Në shkollë na lejohet ta flasim vetëm gjuhën zyrtare të shtetit. Fëmijët që flasin gjuhë tjetër, dënohen, madje edhe nëse flasin derisa luajnë jashtë shkollës. Lëshoje rendin tënd.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 6

Në lagjen tënde ka shkollë në të cilën të gjithë fëmijët e religjioneve të ndryshme janë të mirëseardhur, por aty nuk lejohet të hyjnë fëmijë nuk janë religjiozë. Lëshoje rendin tënd.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

**Kartela ndëshkuese 7**

Prindërit e shokut tënd vitin e kaluar janë ndarë. Tash nëna nuk e lejon atë ta shohë babanë e vet ose gjyshin e gjyshen e tij. Atij vërtet i mungon babai.
Shko prapa 3 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 8

Në klasën tënde është një vajzë që kurrë nuk mund të luajë pas orëve, madje as që ka kohë të mësojë, sepse ajo duhet të kujdeset për vëllezërit e motrat e saj më të vegjël.
Shko prapa 3 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 9

Një djalë i klasës tënde refuzon të ndihmojë në pastrim pas drekës, ngase thotë: "Pastrimi është punë vajzash!".
Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 10

Djemtë e klasës tënde kanë ekip futbollit dhe shumë ekipe sportive pas mbarimit të orarit në shkollë, ndërsa vajzat nuk kanë asnjë ekip.
Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Fletë punë për nxënësit III-1.3c: Fleta me të drejtat për neutralizim



E drejta neutralizuese: Neni 27, Standardi jetësor adekuat:

Fëmijët duhet të jetojnë në kushte të mira jetësore që janë adekuate me nevojat e tyre fizike dhe mendore. Qeveria duhet t'u ndihmojë familjeve që nuk kanë mundësi ta sigurojnë këtë vetë.

E drejta neutralizuese: Neni 2, Mosdiskriminimi:

Të drejtat e Konventës i referohen secilit që, pavarësisht nga raca, ngjyra, religjioni, gjinia, aftësitë, botëkuptimet, opinionet, gjuha që e flet e prejardhja, shteti patjetër duhet ta mbrojë fëmijën nga çfarëdo diskriminimi.

E drejta neutralizuese: Neni 38, Mbrojtja e fëmijëve në kushte të konfliktit luftarak:

Qeveritë nuk duhet të lejojnë që fëmijë nën moshën 15 vjeç të marrin pjesë në armatë ose të marrin pjesë në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë në veprime luftarake. Aq më tepër që fëmijët e zonave luftarake duhet të fitojnë mbrojtje të veçantë.

E drejta neutralizuese: Neni 29, Qëllimet e shkollimit:

Arsimi duhet ta zhvillojë deri në maksimum personalitetin e fëmijës, si dhe shkathtësitë dhe talentin e tij. Arsimi i përgatit fëmijët për jetë. Kjo duhet t'i inkurajojë fëmijët që t'i respektojnë prindërit e tyre, kulturën e tyre, si dhe kulturën dhe kombet e tjera.

E drejta neutralizuese: Neni 30, Fëmijët e pakicave dhe kombeve autoktone:

Fëmijët që u takojnë pakicave dhe kombeve autoktone: kanë të drejtë ta mësojnë dhe ta përdorin gjuhën dhe traditat e familjeve të tyre, pa marrë parasysh se a janë ata të ndarë ose jo nga shumica e njerëzve në shtet.

E drejta neutralizuese: Neni 14, Liria e të menduarit, besimit dhe religjionit:

Fëmijët kanë të drejtë të mendojnë dhe të besojnë çka duan, si dhe ta praktikojnë religjionin e tyre, derisa me të nuk i pengojnë njerëzit e tjerë në përmbushjen e të drejtave të tyre. Prindërit duhet t'i nxisin fëmijët në këto gjëra.

E drejta neutralizuese: Neni 9, Prindër që do të kujdesen për të:

Fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit e tyre, pos nëse kjo është për të mirën e tyre, si në rastet kur prindi sillet keq me fëmijën ose e braktis atë. Fëmijët e prindërve të ndarë kanë të drejtë të mbeten në kontakt me të dy prindërit, pos nëse kjo mund ta lëndojë fëmijën. Qeveria e ka për detyrë t'i sigurojë të gjitha informacionet e nevojshme për ndonjë anëtar të humbur të familjes.

E drejta neutralizuese: Neni 31, Koha e lirë, loja dhe kultura:

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për pushim dhe lojë, si dhe të drejtë që të jenë pjesë e një numrit të madh të aktiviteteve rekreative dhe kulturore.

E drejta neutralizuese: Neni 32, Mbrojtja nga punët e rënda:

Qeveria duhet t'i mbrojë fëmijët nga puna e rrezikshme, e cila mund ta dëmtojë shëndetin ose shkollimin e tyre ose e cila shpie drejt eksploatimit të tyre.

Fletë pune për nxënësit III-1.3ç: Tabela për lojë

1	2	3	4	5	6
12	11	10	9	8	7
13	14	15	16	17	18
24	23	22	21	20	19
25	26	27	28	29	30
36	35	34	33	32	31
37	38	39	40	41	42
43	44	45	46	47	48

Fletë pune për nxënësit III-1.3d: Konventa mbi të drejtat e fëmijës

Konventa mbi të drejtat e fëmijës\

PREAMBULA

Shtetet anëtare në këtë Konventë,

Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është baza e lirisë, drejtësisë dhe e paqes në botë,

Duke mbajtur parasysh faktin se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe kanë vendosur të nxisin përparimin shoqëror e të krijojnë kushte më të mira jetese, në një liri më të madhe,

Duke pranuar se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdonjëri mund të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e parashtruara në to, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinionit politik ose çdo lloj opinionit tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhjeje ose çdo lloj gjendjeje tjetër,

Duke kujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë,

Të bindur se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi,

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi,

Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit,

Duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës,

Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës “fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”,

Duke kujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në një familje ushqyese dhe birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Periudha të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe Konflikti të Armatosur,

Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë,

Duke mbajtur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës,

Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim,

U morën vesh për sa vijon:

PJESA I

Neni 1

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 2

1. Shtetet anëtare angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmijë, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet anëtare angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet anëtare marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 4

Shtetet anëtare angazhohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 5

Shtetet anëtare respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose persona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.

Neni 6

1. Shtetet anëtare njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.

2. Shtete Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

2. Shtetet anëtare sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

Neni 8

1. Shtetet anëtare marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.
2. Në qoftë se një fëmijë i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet anëtare i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni 9

1. Shtetet anëtare garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.
2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.
3. Shtetet anëtare respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.
4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtari ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet anëtare sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni 10

1. Në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të largohen prej tij, për arsye ribashkimi të familjes, trajtohen nga Shtetet anëtare në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi. Shtetet anëtare sigurojnë gjithashtu që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.
2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet anëtare respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni 11

1. Shtetet anëtare marrin masa për të luftuar zhvendosjet dhe moskthimet e paligjshme të fëmijëve në vend të huaj.
2. Për këtë qëllim, Shtetet anëtare nxisin përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 12

1. Shtetet anëtare i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.
2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.

Neni 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

(a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose

(b) Mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 14

1. Shtetet anëtare respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.

2. Shtetet anëtare respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

3. Liria për të manifestuar fenë ose bindjet e tij mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të të tjerëve.

Neni 15

1. Shtetet anëtare njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.

2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 16

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cenimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cenimeve të tilla.

Neni 17

Shtetet anëtare njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për këtë qëllim Shtetet anëtare:

a) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29;

b) Inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të tilla informacioneve dhe materialeve nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare;

c) Inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë;

d) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv, mbajnë parasysh, në mënyrë të veçantë nevojat gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton;

e) Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysh dispozitat e neneve 13 dhe 18.

Neni 18

1. Shtetet anëtare përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.

2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet anëtare u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.

3. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur.

Neni 19

1. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 20

1. Një fëmijë, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.

2. Shtetet anëtare sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, mes tjerash, formën e vendosjes në një familje, të "Kafalasë" sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Neni 21

Shtetet anëtare, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e birësimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe:

(a) Sigurojnë që birësimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që birësimi të lejohet duke mbajtur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për birësimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

(b) Pranojnë se birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje ushqyese ose birësuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme përkujdesjeje në vendin e tij të origjinës;

(c) Sigurojnë që, në rast birësimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barasvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e birësimit në vendin e tij;

(d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast birësimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të;

(e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përpiqen në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Neni 22

1. Shtetet anëtare marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur, për t'i lejuar atij të gëzojë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

2. Për këtë qëllim, Shtetet anëtare bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për bashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

Neni 23

1. Shtetet anëtare pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

2. Shtetet anëtare njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektivisht të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetjak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

4. Shtetet anëtare, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimi, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet anëtare të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 24

1. Shtetet anëtare njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet anëtare përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet anëtare ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

- a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;
- b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
- c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh reziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
- d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
- e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;
- f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

3. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

4. Shtetet anëtare marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 25

Shtetet anëtare i njohin fëmijës, për të cilin është vendosur nga autoritetet kompetente për të qenë nën përkujdesje, mbrojtje ose trajtim fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë vendosje.

Neni 26

1. Shtetet anëtare i njohin çdo fëmije të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore, përfshirë sigurime shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Ndhimat, ku është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe personave përgjegjës për mbajtjen e tij si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 27

1. Shtetet anëtare njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.

3. Shtetet anëtare marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin.

4. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, në rastet kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Shtetet anëtare favorizojnë aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose përfundimin e marrëveshjeve të tilla si dhe miratimin e rregullimeve të tjera të duhura.

Neni 28

1. Shtetet anëtare njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;

b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;

c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;

d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;

e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

3. Shtetet anëtare nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 29

1. Shtetet anëtare u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

- a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
- b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
- c) Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;
- d) Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis seksëve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;
- e) T'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenit 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të atillë që të cenojë lirinë e personave fizikë ose juridikë, për të krijuar e drejtuar qendra arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi që jepet në këto qendra të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

Neni 30

Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmijë që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrojë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 31

1. Shtetet anëtare i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

2. Shtetet anëtare respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni 32

1. Shtetet anëtare njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

2. Shtetet anëtare marrin masa legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Shtetet anëtare në mënyrë të veçantë:

- a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit në punë;
- b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës;
- c) Japin dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

Neni 33

Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Neni 34

Shtetet anëtare marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet anëtare marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

- a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
- b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 35

Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni 36

Shtetet anëtare mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqenien e tij.

Neni 37

Shtetet anëtare sigurojnë që:

- a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;
- b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.
- c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;
- d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 38

1. Shtetet anëtare marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijën.
2. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.
3. Shtetet anëtare nuk rekrutojnë në forcat e tyre të armatosura asnjë person që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona më të rritur se 15 vjeç por më të vegjël se 18 vjeç, Shtetet anëtare përpiqen të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë.
4. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur.

Neni 39

Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Neni 40

1. Shtetet anëtare i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet anëtare kujdesen në veçanti që:

a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:

(i) Të konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;

(ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;

(iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme,

dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

(iv) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta. (v) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.

(vi) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

(vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.

3. Shtetet anëtare përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

(a) Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët konsiderohen të paaftë për të shkelur ligjin penal;

(b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periodha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

Neni 41

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk cenon dispozitat më të favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijës, që mund të parashikohen:

(a) në legjislacionin e një Shteti Palë; ose

(b) në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë Shtet.

PJESA II

Neni 42

Shtetet anëtare marrin përsipër t'ua bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e kësaj Konvente, si të rriturve ashtu edhe fëmijëve, me anë të mjeteve energjike të përshtatshme.

Neni 43

1. Me qëllim që të shqyrtohen përparimet e arritura nga Shtetet anëtare në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër prej tyre në bazë të kësaj Konvente, krijohet një Komitet mbi Drejtat e Fëmijës, i cili kryen funksionet e caktuara si më poshtë.

2. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe që njihen si kompetentë në fushën që trajton kjo Konventë. Anëtarët e tij zgjidhen nga Shtetet anëtare midis shtetasve të tyre dhe marrin pjesë me titull personal, duke pasur parasysh një shpërndarje gjeografike të drejtë dhe sistemet juridike kryesore.

3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votë të fshehtë, nga një listë personash të caktuar nga Shtetet anëtare. Çdo Shtet Palë mund të caktojë një kandidat nga shtetasit e tij.

4. Zgjedhja e parë bëhet jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas zgjedhjet bëhen çdo dy vjet. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara fton me shkrim Shtetet anëtare të propozojnë kandidatët e tyre brenda një afati dymujor. Sekretari i Përgjithshëm bën më pas listën alfabetike të kandidatëve të caktuar, duke cilësuar Shtetet anëtare që i kanë caktuar dhe ua paraqit ata Shteteve Palë në këtë Konventë.

5. Zgjedhjet bëhen gjatë mbledhjeve të Shteteve Palë, të organizuara nga Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, në të cilat duhet të jenë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e Shteteve Palë, kandidatë të zgjedhur në Komitet janë ata që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të Shteteve Palë të pranishëm dhe votues.

6. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata mund të rizgjidhen në qoftë se kandidatura e tyre paraqitet përsëri. Mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbaron pas dy vjetësh. Emrat e këtyre pesë anëtarëve hidhen në short nga Kryetari i mbledhjes, menjëherë pas zgjedhjes së parë.

7. Në rast se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqjen ose deklaron se për çdo arsye tjetër nuk mund t'i kryejë më funksionet e tij në Komitet, Shteti Palë, që kishte paraqitur kandidaturën e tij, emëron një tjetër ekspert nga shtetasit e vet, për të plotësuar vendin e lirë deri në përfundimin e mandatit korrespondues, gjë që i nënshtrohet miratimit të Komitetit.

8. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

9. Komiteti zgjedh byronë e tij për një periudhë prej dy vjetësh.

10. Mbledhjet e Komitetit zakonisht mbahen në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm, të caktuar nga Komiteti. Komiteti mblidhet zakonisht çdo vit. Zgjatja e sesioneve të tij përcaktohet dhe ndryshohet, në rast se është e nevojshme, nga një mbledhje e Shteteve Palë në këtë Konventë, me rezervën e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara vë në dispozicion të Komitetit personelin dhe pajisjet e nevojshme, për të kryer me efektshmëri funksionet që i janë besuar në bazë të Konventës.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të krijuar në bazë të kësaj Konvente paguhën nga të ardhurat e OKB-së, sipas kushteve dhe modaliteteve të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 44

1. Shtetet anëtare marrin përsipër të paraqitin në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raporte mbi masat e marra për të përmbushur të drejtat e njohura në këtë Konventë dhe mbi përparimet e realizuara në gëzimin e këtyre të drejtave:

- a) Brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Shtetet anëtare;
- b) Në vazhdim në çdo pesë vjet.

2. Raportet e paraqitura në zbatim të këtij neni tregojnë faktorët dhe vështirësitë, në rast se ka, që kanë ndikuar në shkallën e përmbushjes nga Shtetet anëtare të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Raportet duhet të përmbajnë gjithashtu të dhëna të mjaftueshme për t'i dhënë Komitetit një ide të plotë për zbatimin e Konventës në vendin përkatës.

3. Shtetet anëtare, që kanë paraqitur në Komitet raportin e parë të plotë, nuk përsërisin në raportet që i paraqesin atij në vazhdim, sipas pikës (b) të paragrafit të parë të këtij neni, sqarimet kryesore, të komunikuar qysh më parë.

4. Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të dhëna plotësuese, që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

5. Komiteti i paraqit çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror, një raport mbi veprimtarinë e tij.

6. Shtetet anëtare sigurojnë një shpërndarje të gjerë të raporteve të tyre në vendet e tyre.

Neni 45

Për të arritur zbatimin efektiv të Konventës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën që mbulon kjo Konventë:

- a) Agjencitë e specializuara, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të gjitha organet e tjera kompetente, që ai do ta gjykojë të arsyeshme, për të dhënë mendime të specializuara mbi zbatimin e Konventës në fusha që kanë të bëjnë me mandatin e tyre përkatës. Ai mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur raporte mbi zbatimin e Konventës në sektorët që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre;
- b) Komiteti u transmeton agjencive të specializuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organeve të tjera kompetente, në rast se e sheh të nevojshme, çdo raport të Shteteve Palë, që përmban një kërkesë ose që tregon një nevojë për këshilla ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e Komitetit, në rast se ka të tilla;
- c) Komiteti mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme, që t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm, të ndërmarrë në emër të tij studime për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;
- d) Komiteti mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme, të bazuara në të dhënat e marra në zbatim të neneve 44 dhe 45 të kësaj Konvente. Këto sugjerime dhe rekomandime të natyrës së përgjithshme i transmetohen çdo Shteti Palë të interesuar dhe i përcillen për dijeni Asamblesë së Përgjithshme, të shoqëruara, në rast se ka të tilla, me vërejtjet e Shteteve Palë.

PJESA III

Neni 46

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet.

Neni 47

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Konventa do të qëndrojë e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 49

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit.
2. Për secilin Shtet që ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 50

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon pastaj amendamentin e propozuar Shteteve Palë, duke kërkuar që t'i bëjnë të ditur nëse janë për thirrjen e një konference të Shteteve Palë për shqyrtimin e propozimit dhe të hedhjes në votë. Nëse brenda katër muajve pas datës së këtij komunikimi, të paktën një e treta e Shteteve Palë shprehen për thirrjen e një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën kujdesin e

Organizatës të Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jetë pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë.
3. Kur një amendament hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për të gjithë Shtetet anëtare, që e kanë pranuar dhe Shtetet e tjerë që mbeten të lidhur me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të gjithë amendamentet e mëparshme të pranuar prej tyre.

Neni 51

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe ua dërgon të gjithë Shteteve tekstin e rezervave të bëra nga Shtetet në çastin e ratifikimit ose të aderimit.
2. Nuk lejohet asnjë rezervë e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.
3. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili informon për këtë të gjithë Shtetet anëtare në Konventë. Njoftimi hyn në fuqi në datën kur ky është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 52

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës kur njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitues i kësaj Konvente.

Neni 54

Origjinali i kësaj Konvente, bërë në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, franceze dhe ruse, me vlerë të barabartë, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Për vërtetim, të nënshkruarit, të plotfuqishëm e të ngarkuar ligjërisht nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.



¹kinez

¹me tinguj

¹në Kinë.

¹është

¹me tela

¹plotësisht



² Muri

² ndërtimi

² Balenat

² Busulla

² kitara.

² muzikë



³ i vetëm

³ nga Hëna.

³ të mëdhaja

³ e parë

³ instrument,

³ ka kompozuar



është

4

shihet

4

në largësi.

4

Pianoja

4

edhe kur

4

i shurdhër.

4



⁵që

⁵komunikojnë

⁵është bërë

⁵njësoj si

⁵Betoveni

⁵ka qenë

Fletë pune për nxënësit III-3.3: NDIHMË



Pas përfundimit të pushimit të gjatë, të gjithë fëmijët përnjëherë marrin të hyjnë në derën e shkollës. Në atë rrëmujë nxënësi i klasës së parë Pjetri bie dhe nuk mund të ngrihet, sepse fëmijët që janë pranë tij as që e shohin se dikush është rrëzuar, andaj vazhdojnë të shtyhen.

Si mund të ndihmohet nxënësi i klasës së parë, Pjetri?



Në orën e gjuhës amtare Irfani nuk e ka sjellë në klasë fletoren e detyrave të shtëpisë. Arsimtari fillon ta qortojë me hidhërim për lëshimin e bërë. Irfani hesht dhe vetëm shikon në tokë, ndërsa arsimtari gjithnjë e më shumë i bërtet Disa fëmijë të klasës e dinë se nëna e tij është shumë e sëmurë dhe se Irfani çdo ditë kujdeset për të, madje edhe e ushqen atë.

Si mund t'i ndihmojnë nxënësit e tjerë Irfanit?



Disa fëmijë luajnë futboll në fushë. Një fëmijë e hedh topin aq shumë, saqë ai del jashtë gardhit të fushës. Në atë moment një njeri është duke u shëtitur në parkun para fushë së futbollit kur topi bie pikërisht para tij.

Si mund t'u ndihmojë ky njeri fëmijëve?



Një njeri me bastun të bardhë përpiqet ta kalojë rrugën në vendkalimin e këmbësorëve, kur semafori është i gjelbër. I bën disa hapa në vendkalim, por e dëgjon zhurmën e një motori nga ana e djathtë, andaj ndalet që ta lëshojë. Pastaj vazhdon edhe disa hapa ngadalë dhe me kujdes. Në të njëjtën kohë vendkalimin e këmbësorëve e kalojnë fëmijët që shkojnë në shkollë.

Si mund t'i ndihmojnë fëmijët njeriut?



Zana kohëve të fundit gjithnjë e më shumë vjen me njolla të ënjtjes në fytyrë dhe zakonisht vesh bluza me mëngë të gjata, madje edhe kur është shumë nxehtë. Ajo i ka treguar në besim shoqes së saj më të afërt, Emës, se babai i saj ndonjëherë pi shumë dhe atëherë edhe për një gjë të imët mund të shpërthejë dhe ta rrahë atë.

Si mund t'i ndihmojë dhe ta mbështetë Ema shoqen e saj?



Jana është një vajzë shumë “e gjallë”. Ajo vazhdimisht vrapon, kërcen dhe ngjitet nëpër drurë. Njëherë, kur po kërcente me shokët e saj nga një mur i lartë, ra dhe e gërvishti gjurin. Jana vazhdoi të ecë, por gjuri e digjte shumë.

Si mund t’i ndihmojnë shokët Janës?



Në shfaqjen e patronatit të shkollës Elviri duhet ta recitojë një vjershë shumë të gjatë. Ai e di vjershën shkëlqyeshëm dhe krenohet që pikërisht ai është zgjedhur që ta thotë atë para të tjerëve. Por, në ditën e shfaqjes, para sallës së mbushur me nxënës, arsimtarë e prindër, Elviri në strofën e tretë bëri gabim, u shqetësua dhe nuk dinte si të vazhdojë. I turpëruar heshti dhe iku nga scena.

Si mund t’i ndihmonin shokët Elvirit para se të ikte nga scena.
Si mund t’i japin mbështetje pasi të ndodhë kjo?




Një gjysh dhe një gjyshe po kthehen nga tregu me strajca të mbushura me pemë e perime. Përgjyshta bën shumë vapë, andaj ata kohë pas kohe ndalen të pushojnë. Kështu kalojnë pranë një internet-kafeje në të cilën “vlon” nga fëmijët dhe ata ndalen edhe aty të pushojnë pak.

Si mund t’u ndihmojnë fëmijët atyre?



Lea është një nxënëse e re në klasë. Ajo është shpërngulur në këtë lagje kah fundi i gjysmëvjetorit të parë dhe tani filloi të mësojë në këtë shkollë. Lea nuk e njeh asnjë fëmijë të klasës e as të lagjes. Ajo ulet vetë dhe, kur dikush e pyet diçka, ajo përgjigjet shumë shkurt. Edhe në shtëpi shkon vetë.

Si mund t’i ndihmojnë fëmijët Leës?





T'I DIJË
DETYRAT
E MATEMATIKËS

TË JETË
SHOK
ME TË GJITHË

TË JETË
NXËNËS
I DASHUR
PËR ARSIMTARËT

TË DIJË
TË LEXOJË
MIRË



TË DIJË
T'U NDIHMOJË
NXËNËSVE
NË ZGJIDHJEN
E PROBLEMEVE

TË REAGUOJË NDAJ
PADREJTËSIVE

TË DIJË
TË LUAJË
NË KITARË

TË KETË PESËSHE NË
TË GJITHA LËNDËT



Test në lëndën e historisë

Arsimtarja e historisë ju lajmëron se do të keni test. Ajo ju propozon dy kohë: në orën e fundit të mërkurën ose të shtunën në orën 8. Me votim gjysma e nxënësve janë deklaruar se testin dëshirojnë ta bëjnë të mërkurën, ndërsa gjysma tjetër – të shtunën. Si të merret vendim dhe njëherazi të shmangen grindjet mes nxënësve?

Zgjedhja e kryetarit

Në klasën tuaj zgjidhet kryetar. Për këtë detyrë janë dy kandidatë. Njëri është Miki, i cili është më i popullarizuar në klasë me argëtimin që e ofron, por ai është më së paku me ndikim te arsimtarë. Ndërsa kandidati tjetër është Beni, për të cilin mendohet se do të ishte kryetar i mirë, sepse ai mundohet më shumë për klasën. Nxënësit e klasës nuk dëshirojnë të hidhërohen as me njërin as me tjetrin, duke e ditur se për të dy kjo zgjedhje është e rëndësishme. Si ta zgjidhni më të mirin (Benin), ndërsa Miki të mos hidhërohet me shokët që nuk e kanë votuar?

Kuizi në biologji

Nga kryetarët e klasave të shkollës suaj kërkohet të vendosin se a do të marrin pjesë klasat e tyre në kuizin e biologjisë. Emina, e cila është kryetare e klasës suaj dëshiron të flasë me secilin nxënës individualisht që të shohë se sa është i gatshëm që të marrë pjesë në kuiz. Ajo nuk është e detyruar ta pranojë pjesëmarrjen, por dëshiron të dijë se a ka dikush që shumë do të dëshironte që klasa e tyre të marrë pjesë në kuiz. Pas dëgjimit të të gjithëve, Emina vendos. Si duket ky vendim?

Renovimi

Drejtorja e shkollës ju lajmëron se janë parashikuar disa mjete materiale për renovimin e klasës suaj. Ata ju propozojnë të zgjidhni: tabelë për të shkruar, roleta në dritare dhe karrige të reja. Klasa juaj ka kohë një orë për t'u marrë vesh se çka dëshiron të zgjedhë. Si do ta bëni këtë?

Ekskursion

Kah fundi i vitit klasën tuaj e informojnë se është planifikuar ekskursion dyditor sipas zgjedhjes së nxënësve. Por, ju kurrësi të merreni vesh. Një pjesë e juaja insistojnë të shkohet në Ohër, ndërsa të tjerët tërë kohën brohorisin se “si Struga s’ka tjetër”, duke kërkuar të shkohet në Strugë. Si të merrni vendim, e të gjithë të jenë të kënaqur?



VENDIMI I LIDERIT

Lideri së pari dëgjon se çka mendon secili anëtar i grupit, e pastaj merr vendim në emër të grupit.

VENDIMI „I RASTIT“

Grupi e hedh një monedhë ose e tërheqë një fije kashte që të vendosë.

VENDIMI ME VOTIM

Propozohen më shumë vendime, ndërsa pranohet ajo për të cilën më shumë anëtarë të grupit do të deklarohen se është më e pranueshme për ata. Mund të votohet publikisht, me ngritje të dorës (të gjithë shikojnë kush si voton) ose fshehtas, duke e shkruar në letër (askush nuk e di se kush për kë ka votuar).

VENDIMI ME KOMPROMIS

Secili në grup pajtohet të heq dorë nga pak prej diçkaje që e dëshiron dhe grupi bashkërisht vjen deri te një vendim i pranueshëm për të gjithë.

**MEQË DËSHIROJMË TË KEMI NOTA TË MIRA,
NUK DO T'I KUNDËRSHTOJMË ARSIMTARËT.**

+ (çka fitojmë)

**MEQË DËSHIROJMË TË KEMI NOTA TË MIRA,
NUK DO T'I KUNDËRSHTOJMË ARSIMTARËT.**

– (çka humbim)

Secili fëmijë ka të drejtë:

1. të zgjedhë çka të shikojë në televizion
2. të pyetet a ka dëshirë të ketë ledhatak dhe çfarë
3. të ketë para xhepi
4. të vendosë çka do të hajë për drekë
5. të vendosë se a dëshiron të lexojë lektyra apo jo
6. të vendosë se çka do të veshë
7. të jetë i dëgjuar dhe të merret seriozisht
8. të pyetet se a të jetojë familja në shtëpi apo në banesë
9. të shprehet se ku dëshiron të shkojë familja për pushim vjetor
10. të vendosë se a do të mësojë për hartim apo jo
11. të vendosë derisa do të rrijë jashtë
12. të vendosë sesi do ta festojë ditëlindjen
13. për gjithçka të pyetet se çka dëshiron
14. të vendosë me kë do të shoqërohet
15. të vendosë kur do t'i bëjë detyrat e shtëpisë
16. të pyetet se çfarë mobiliesh dëshiron të blihen
17. në mëngjes të flejë sa dëshiron ai vetë
18. të vendosë kur dhe me kë do të luajë
19. të refuzojë të bëjë gjëra që nuk i pëlqejnë
20. të vendosë sa kohë do të shikojë televizion

Fletë punë për nxënësit III-6.1a: E lindur – e mësuar

SJELLJA	E LINDUR	E MËSUAR
Frymëmarrja.		
Kafshimi i thonjve.		
Gënjeshtër.		
Gëlltitja.		
Përthypja e çam-çakëzit.		
Lidhja e lidhëzave.		
Ndihma e të tjerëve.		
Shkelmimi.		
Teshtitja.		
Gjuajtja e topit.		
Shkrimi.		
Vizatimi në mure.		
Gogësima.		
Vozitja e biçikletës.		
Shenja me sy.		
Noti.		
Fyerja.		

Fletë punë për nxënësit III-6.1b: Adekuate – joadekuate

SJELLJA	A	JA	A-JA
Këndimi.			
Loja me top në banesë.			
Vrapimi në korridore.			
Hedhja e mbeturinave në kosh.			
Gjuajtja e maceve me guralecë.			
Përthypja e çam-çakëzit.			
Leximi i librit.			
Ndihma e tjerëve.			
Kur i biem dikujt me shuplaka.			
Kundërshtimi i prindërve.			
Huazimi pa marrë leje.			
Vizatimi nëpër mure.			
Pështymja e dikujt.			
Kalimi i rrugës në dritë të gjelbër.			
Fyerja.			



KUKULLAT JANË VETËM PËR VAJZA

DJEMTË NUK QAJNË

FUTBOLLI ËSHTË VETËM PËR DJEMTË

VAJZAT DUHET TË NDIHMOHEN PËR
DETYRAT E SHITËPISË

KUR KA NDONJË PROBLEM NË SHKOLLË,
MENJËHERË AKUZOHEN DJEMTË

DJEMTË MUND TË SHAJNË, NDËRSA VAJZAT
NUK GUXOJNË

DJEMTË DUHET T'U NDIHMOJNË VAJZAVE
NË PUNË

1. Nëna e përkujtoi Ogin se duhet t'i bëjë detyrat e shtëpisë. Ai i tha nënës së tij se do t'i bëjë detyrat e shtëpisë, por sapo filloi, i ndërpreu që t'i ndihmojë motrës së tij më të vogël që ta rregullojë kamionin e prishur.

- » A ka vepruar Ogi me përgjegjësi? Pse
- » Çka do të ishte sjellje e përgjegjshme në këtë situatë? Pse?

2. Ogi kishte harruar se ditën e ardhshme kishin test në matematikë dhe nuk u ul të mësojë. Ai e dinte se arsimtarja do të dëshpërohet me te, andaj tha se ditën e kaluar ka qenë i sëmurë dhe për atë shkak s'ka mundur të mësojë.

- » A ka vepruar Ogi me përgjegjësi? Pse
- » Çka do të ishte sjellje e përgjegjshme në këtë situatë? Pse?

3. Ogi e pa një qen të madh të zi sesi qëndronte i lidhur dhe e priste pronarin tij para një shitoreje. I dukej i mërzitur, andaj shkoi ta përkëdhelë.

- » A ka vepruar Ogi me përgjegjësi? Pse
- » Çka do të ishte sjellje e përgjegjshme në këtë situatë? Pse?

4. Ina, shoqja e klasës së Ogit, ia shpaloi zemrën – ia tha një sekret. Ogi nuk ia tregoi këtë askujt, pos Mensurit. Mensuri dhe Ogi janë shokë shumë të mirë dhe gjithçka i tregojnë njëri-tjetrit.

- » A ka vepruar Ogi me përgjegjësi? Pse
- » Çka do të ishte sjellje e përgjegjshme në këtë situatë? Pse?



Rregulla në KOMUNIKACION për KËMBËSORËT


Rregulla

1. _____
2. _____
3. _____

Sanksione

1. _____
2. _____
3. _____

Mbikëqyr _____



Rregulla në KOMUNIKACION për VOZITËSIT


Rregulla

1. _____
2. _____
3. _____

Sanksione

1. _____
2. _____
3. _____

Mbikëqyr _____





Rregulla në FUTBOLL

Rregulla

1. _____
2. _____
3. _____

Sanksione

1. _____
2. _____
3. _____

Mbikëqyr _____



Rregulla të sjelljes në TEATËR


Rregulla

1. _____
2. _____
3. _____

Sanksione

1. _____
2. _____
3. _____

Mbikëqyr _____





Rregulla të sjelljes në PISHINË

Rregulla

1. _____
2. _____
3. _____

Sanksione

1. _____
2. _____
3. _____

Mbikëqyr _____



Fletë punë për nxënësit III-8.1a: Në pajtim me kushtetutën ose jo?



1. Në një shkollë fëmijët turq kërkojnë revista në gjuhën turke, e jo vetëm në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

2. Prindërit dhe farefisi i fëmijëve që kanë vdekur ose janë lënduar në fatkeqësi komunikacioni të shkaktuar nga ndonjë vozitës i dehur që është ndeshur me autobusin që ka bartur fëmijë në ekskursion, kërkojnë dënim me vdekje për vozitësin e pandërgjegjshëm.

3. Përfaqësuesit e policisë e kanë kapur një njeri për të cilin mendohet se ka vënë bombë në një qendër tregtare. Ata e kanë dërguar atë në stacion të policisë dhe e kanë rrahur që ai të tregojë se ku e ka fshehur bombën.

4. Në një klasë, kur duhet të merret vendim për uniformat e nxënësve, arsimtarja e merr vetëm mendimin e nxënësve të shkëlqyeshëm.

5. Dy policë hynë në banesën e një djaloshi dhe e kontrollojnë, ngase një kalimtar i rastit u ka thënë se aty jeton djaloshi që para dy ditëve e ka vjedhur shitoren.

6. Një fëmijë në gazetën e shkollës ka shkruar se ai mendon se administrata e shkollës nuk ka ndërmarrë sa duhet masa që ta pengojë sjelljen e dhunshme të disa fëmijëve të lagjes që gjatë pushimit hyjnë në oborrin e shkollës dhe i maltretojnë fëmijët. Për shkak të këtij shkrimi djaloshi është përjashtuar nga shkolla.

7. Një vajzë për shkak të bindjeve të saj religjioze nuk dëshiron të ushtrojë në orët e edukatës fizike me triko dhe kërkon të ushtrojë e veshur me trenerka. Arsimtarja e edukatës fizike e përzë nga ora, ngase ajo mendon se vajza duhet të jetë e veshur si të gjitha vajzat e tjera.

8. Një grup i nxënësve e kanë formuar një shoqatë shkolllore dhe pas orëve protestojnë para shkollës duke kërkuar që arsimtarët të mos pinë duhan nëpër korridoret e shkollës. Ata thonë se nëse kjo dukuri nuk ndërpritet, ata nuk do të shkojnë në mësim.

9. Dy nxënës të klasës së shtatë shpesh mungojnë prej orëve, sepse janë të punësuar në fabrikën e tekstilit të qytetit. Prindërit e tyre nuk punojnë, ashtu që ata duhet vetë të gjejnë mënyrë që ta mbajnë familjen.

10. Në një fatkeqësi komunikacioni është lënduar vozitësi i veturës dhe një i pastrehë që në ato çaste po e kalonte rrugën. Të pranishmit e kanë ftuar ndihmën e shpejtë dhe e kanë dërguar vozitësin në spital, ndërsa i pastrehu ka ngelur i shtrirë në rrugë.

Fletë punë për nxënësit III-8.1b: Nene të kushtetutës së R. së Maqedonisë

Neni. 7 Në Maqedoni flitet dhe mësohet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e bashkësive të tjera etnike që jetojnë këtu.
Neni. 9 Njerëzit në Maqedoni janë të barabartë dhe kanë të drejta të barabarta.
Neni. 10 Jeta e secilit njeri është gjëja më e rëndësishme. Në Republikën e Maqedonisë nuk ka dënim me vdekje.
Neni. 11 Askush nuk guxon të maltretohet, të nënçmohet dhe të torturohet.
Neni. 16 Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të mendojnë se çka duan, kanë të drejtë për religjionin ose besimin e tyre dhe kanë të drejtë që mendimet e tyre t'i shprehin publikisht dhe të dëgjojnë se çka mendojnë të tjerët.
Neni. 20 dhe neni. 21 Mund të bashkohemi dhe të protestojmë.
Neni. 23 Kur t'i mbushim 18 vjet, mund të zgjedhim dhe të na zgjedhin.
Neni. 24 Mund të ankoheni në organet shtetërore.
Neni. 26 Askush nuk guxon të na hyjë në shtëpi pa ftesë ose pa vendim të gjykatës.
Neni. 27 Mund të shëtisim nëpër tërë vendin ku të duam. Mund të kthehemi në vendin tonë kur të dëshirojmë.
Neni. 33 Secili duhet t'ia paguajë taksat për shtetin.
Neni. 35 Shteti kujdeset për të dobëtit dhe të varfrit.
Neni. 39 Njerëzit kanë të drejtë të mbrojtjes shëndetësore.
Neni. 40 Prindërit dhe fëmijët duhet të kujdesen për njëri-tjetrin.

Neni. 42

Shteti në veçanti kujdeset për fëmijët. Fëmijët e moshës nën 15 vjeç nuk guxojnë të jenë të punësuar.

Neni. 43

Të gjithë duhet të kujdesemi për natyrën.

Neni. 44

Të gjithë kanë të drejtë të mësojnë.

Neni. 48

Njerëzit kanë të drejtë për përdorimin e gjuhës së ndryshme, të kulturës së ndryshme dhe të zakoneve të ndryshme.

Neni. 61

Organi më i lartë në shtet është Kuvendi. Në të miratohen ligjet.

Neni. 79

Kryetar i shtetit e përfaqëson shtetin dhe udhëheq me ushtrinë.

Neni. 88

Qeveria kujdeset për zbatimin e ligjeve që i miraton Kuvendi. Qeveria është e përbërë nga ministrat dhe kryetari i Qeverisë.

Neni. 98

Kur i shkel dikush ligjet, atë e gjykojnë në gjykata. Gjykata më e lartë është Gjykata Supreme.

Neni. 106

Prokurori publik i ndjek ata që e shkelin ligjin.

Neni. 108

Gjykata Kushtetuese kujdeset që të gjitha ligjet të jenë të bëra ashtu siç parashikon kushtetuta.

Neni. 114

Njerëzit formojnë komuna në të cilat merren vesh si të jetojnë me mirë bashkërisht.

Neni. 118

Shteti bashkëpunon me shtetet e tjera dhe nënshkruan marrëveshje me ato. Me disa shtete mund të lidhë edhe aleancë dhe bashkërisht të formojnë grup të veçantë.

Neni. 122

Ushtria e mbron territorin e shtetit nga sulmet e jashtme.



**MAQEDONIA
IDILË DIMËRORE**

**MAQEDONIA
MUNDËSI TË NDRYSHME PËR VERIM**

**MAQEDONIA
VEND ME HISTORI TË PASUR**

**MAQEDONIA
VEND ME MONUMENTE TË PANUMËRTA
RELIGJIOZE**

**MAQEDONIA
TRYEZË E BEGATSHME**

**MAQEDONIA
VEND I LLOJEVE AUTOKTONE TË LLOJEVE TË
KAFSHËVE**

Fletë punë për nxënësit III-8.2b: Fotografi nga Maqedonia


Mavrovë



Mali Sharr




Krushevë



Liçeni i Berovës



Kozhuf



Skupi



Heraklea



Stobi



Kështjella e Shkupit



Kështjella e Vinicës




Liqeni i Ohrit



Liqeni i Dojranit



Pelister



Kanjon i në Matkë



Ujëvarat e Smolarit



Teqja – Tetovë



Xhamija e larme - Tetovë



Shën Jovan Kaneo - Ohër



Shën Jovan Bigorski



Xhami në çarshinë e vjetër të shkupit



Mollë



Bostan



Rrush



Specë



Tafçe – Grafçe



Bakllavë



Rëqebulli



Ariu




Qeni i sharit



Fluturat



Trofta





MEDICINË

(mbjella e organeve, operacionet me laser)

TEKNOLOGJIA E KOMPJUTERIT (internet,
telefon celular, robotë)

MBROJTJA E NATYRËS

(filtra për ajër, prodhimi i energjisë diellore,
riciklimi)

SPORT

100 metra - vrapim:

9,69 sek. meshkuj; 10,49 sek. femra

100 metra - not:

44,94 sek. meshkuj; 51,70 sek. femra

kërcim në lartësi:

2,45 min. meshkuj; 2,09 min. femra

GJITHËSIA

(njerëzit në vizitë të Hënës, gjurmimi i
marsit, fluturime turistike në hapësirë,
teleskopi i gjithësisë)

Fletë pune për nxënësit III-9.2: Dallimet e njëjta

	NGJASHMËRITË mes meje dhe...	DALLIMET mes meje dhe...
ANËTARËT E FAMILJES	1. _____ 2. _____ 3. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____
SHOKËT	1. _____ 2. _____ 3. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____
BANORËT NË BASHKËSINË TIME	1. _____ 2. _____ 3. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____
QYTETARËT E MAQEDONISË	1. _____ 2. _____ 3. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____
NJERËZIT NË BOTË	1. _____ 2. _____ 3. _____	1. _____ 2. _____ 3. _____



POLIC

MJEK

ARSIMTAR


ZJARRFIKËS

SHKENCËTAR

ARTIST FIGURATIV

PASTRUES/E

Fletë pune për nxënësit III-10.3: Heroi/heroina ime



Heroi/heroina ime quhet _____

Për mua hero/heroinë është për shkak se _____

Tre fjalë që e përshkruajnë më së miri heroin/heroinën time janë








1. _____

2. _____





3. _____

Nga hero/heroina ime mësova _____

Fletë pune për nxënësit III-11.1: Format gjeometrike



Fletë pune për nxënësit III-11.2a: Shenjat e kategorizimit

 gjithë publiku	KATEGORIA E PARË Programe të dedikuara për gjithë publikun.
 mbikëqyrje e prindit	KATEGORIA E DYTË Programe që mund ta shqetësojnë publikun e mitur. Rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.
	KATEGORIA E TRETË Programe që nuk rekomandohen për fëmijë të moshës nën 12 vjeç. Është e patjetërsueshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.
	KATEGORIA E KATËRT Programe që nuk rekomandohen për fëmijë. Është e patjetërsueshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.
	KATEGORIA E PESTË Programe joadekuate për publikun e moshës nën 18 vjeç.

Fletë pune për nxënësit III-11.2b: Shpjegimi i kategorive



Programet mund të emetohen pa ndërprerë gjatë njëzet e katër orëve. Prandaj duhet ta kemi parasysh se një njëzet e katër orët televizive në publikun më të gjerë përfshihen edhe fëmijët e klasës së pestë, andaj trajtimi i temave problematike në programet për gjithë publikun patjetër duhet të jetë adekuat edhe për popullatën më të re. Përdorimi i fjalorit vulgar duhet të vihen në nivelin më të ulët. Paraqitja e trupit të njeriut të zhveshur lejohet vetëm në gjendje neutrale, natyrore, pra jashtë çdo konteksti erotik. Nuk rekomandohet paraqitja e armëve të vërteta. Është mirë që skenat dhe/ose pamjet me akte të dhunës të kufizohen vetëm në kanosje jo shumë të mëdha, pa kurrfarë ashpërsie verbale ose psiko-fizike në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Ndalohet paraqitja e narkomanisë, alkoolizmit dhe llojeve të ndryshme të sjelljeve devijuese. Skenat e frikës duhet të jenë të menduara në bazë të moshës së shikuesve më të rinj.



Këto programe nuk lejohet të shfaqen para orës 17:00 dhe pas orës 05:00 dhe nuk rekomandohet për fëmijë të moshës nën 8 vjeç. Këtu mund të përfshihet një spektër më i madh i temave: sjellja devijuese, dhuna familjare, racizmi etj. Megjithatë programet në asnjë rast nuk guxojnë të nxisin dhunë, e as të përfshijnë në vete çfarëdo afirmimi të sjelljes ofenduese për dinjitetin njerëzor. Nuk lejohet as përdorimi i tepërt i fjalorit vulgar. Lejohet paraqitja e trupit të zhveshur të njeriut në mënyrë neutrale, po pa pasur kontekst erotik. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me erotike duhet të jenë jashtëzakonisht të rralla dhe të patheksuara, diskrete dhe pa aluzione vulgare. Lejohet paraqitja e paktë e dhunës, por pa detaje të ashpërsisë, konform thurjes së skenarit, por pa u theksuar prania e armëve të vërteta ose teknikave të rrezikshme për hesape ndërnjerëzore. Është e pëlqyeshme që senat dhe/ose pamjet që kanë për qëllim frikën të mos e zgjasin momentin krizë të situatës së paraqitur. Rrethanë lehtësuese është se ngjarja ndodhë në një botë të fantazisë.



Këto programe nuk guxojnë të emetohen para orës 00:00 dhe 05:00. Në to tolerohen përshkrimet, skenat dhe/ose pamje e dhunës, si dhe paraqitja e marrëdhënieve erotike. Në to respektohet e drejta autonome dhe vetëdija e personit të rritur që të vendosë gjatë zgjedhjes së llojit të kategorisë së programit që e ndjek. Emetimi i pornografisë dhe sadizmit është i ndaluar me Ligjin për veprimtari radiodifuzive dhe në asnjë rast nuk duhet të vihet në lidhje me këtë kategori programesh. Në këtë kategori të programeve nuk ka kufizime të temave, ndërsa kufizimet e vetme në lidhje me mënyrën e përpunimit burojnë nga Ligji për veprimtari radiodifuzive (neni 69 dhe 70). Paralajmërimet për këto programe nuk guxojnë të emetohen para orës 22:00 dhe pas orës 05:00.



Këto programe nuk guxojnë të emetohen para orës 21:00 dhe pas orës 05:00. Bëhet fjalë për programe në skenarin e të cilave në mënyrë sistematike ka përshkrime të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, të cilat mund ta tmerrojnë publikun adoleshent. Përpunimi i temave serioze është i pranueshëm, por duhet të jetë adekuat me moshën e përshkruar të publikut. Lejohet përdorimi i fjalorit të pakujdesshëm, vulgariteti dhe brutaliteti. Megjithatë kjo patjetër duhet të ketë masë të arsyeshme dhe të jetë e arsyetuar me domosdoshmërinë e funksionit dramatik ose në kontekst të programit informativ-dokumentar. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamje e dhunës dhe erotikës, si dhe lidhja eventuale ndërmjet këtyre dy faktorëve në zhvillimin e narracionit, nuk duhet t'i theksojnë lëndimet fizikë dhe/ose pasojat psiko-fizike të lëndimeve, e as të fokusohen në detajet fizike. Nuk duhet t'u jepet rëndësi e veçantë armëve dhe teknikave të hesapeve ndërnjerëzore që janë të lehta për imitim dhe me potencial të madh që të ndikojnë në mënyrë sugjестive në pjesët psikikisht më pak stabile të publikut ose te personat emocionalisht të dobët. Paraqitja e narkomanisë është e lejuar, por pa detaje të fazave të aktit të (keq)përdorimit të drogës, ndërsa duhet të ekuilibrohet paraqitja e pasojave, kjo e arsyetuar me funksionin e karakterizimit të personazheve dhe në mënyrë komplementare në tërësi në lloje të ndryshme: në formë të lojës, në formë arsimore, informative dhe/ose si program dokumentar. Paralajmërimet për këso programe nuk guxojnë të jenë me përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund ta shqetësojnë publikun adoleshent.



Këto programe nuk guxojnë të emetohen para orës 22:00 dhe pas orës 05:00. Bëhet fjalë për programe të cilat në skenarin e tyre kanë përshkrime të shpeshta me skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, që mund ta tmerrojnë publikun adoleshent. Këtu nuk ka kufizime të temave. Shpesh lejohet përdorimi i fjalorit të pakujdesshëm, por përdorimi i tepërt i tyre është vështirë i pranueshëm. Lejohet paraqitja e erotikës dhe marrëdhënieve seksuale, por pa paraqitje eksplicite, pa detaje pornografike. Nevojitet kontekst i kujdesshëm për shprehjet verbale dhe me gjeste të aluzioneve të fuqishme seksuale, sepse ato mund ta lëndojnë dinjitetin njerëzor. Paraqitja e narkomanisë është e lejuar, por pa detaje të fazave të aktit të (keq)përdorimit të drogës, ndërsa duhet të ekuilibrohet paraqitja e pasojave, kjo e arsyetuar me funksionin e karakterizimit të personazheve dhe në mënyrë komplementare në tërësi në lloje të ndryshme: në formë të lojës, në formë arsimore, informative dhe/ose si program dokumentar. Janë të pranueshme përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe pasojat e dhunës, por jo edhe paraqitja e sadizmit ose çfarëdo shprehje tjetër e johumanitetit dhe maltretimit të njerëzve dhe kafshëve. Paralajmërimet për këto programe nuk guxojnë të jenë me përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund ta shqetësojnë publikun adoleshent.

Fletë pune për nxënësit III-12.1a: Fusha për lojë

[illegible]



Situata 1

Situata në shkollë

Pjesëmarrës - 5 persona (1 arsimtar dhe 4 nxënës)

Situata – arsimtari ligjëron, ndërsa nxënësit pëshpëritin diçka ndërmjet vete duke i dhënë njëri-tjetrit letra.

Sjellja – arsimtari fillon të bërtasë, t'i quajë me emra neveritës, të kanoset dhe t'i ndëshkojë fizikisht (ua tërheqë veshët, u bie sikur troket në derë etj.)

Situata 2

Situata në vetëshërbim

Pjesëmarrës - 5 persona (1 shitëse dhe 4 fëmijë)

Situata – fëmijët vijnë në vetëshërbim që të blejnë disa cikërrima

Sjellja – fëmijët zakonisht janë të zhurmshëm (por, jo edhe të pasjellshëm) dhe dëshirojnë të shikojnë e të prekin; shitësja i pret me padurim, i ofendon dhe përpiqet që sa më shpejt të lirohet prej tyre

Situata 3



Situata në shtëpi


Pjesëmarrës - 3 persona (babai, nëna dhe fëmijë)

Situata – fëmija vjen nga shkolla në shtëpi me një notë të dobët

Sjellja – prindërit fillojnë ta ofendojnë, ta nënçmojnë dhe ta rrahin

Fletë pune për nxënësit IV-1.3: Produktet ushqimore 1





Fletë pune për nxënësit IV-1.7a: Shprehitë e shëndosha

Dritoni është fëmijë që nuk ka brenga në jetë. Ai i dëshiron dhe i fiton vetëm gjërat më të bukura. Pëlqen të hajë çokollata, gjëra të ëmbla, biskota, bonbone etj. Ai pi vetëm koka-kolë. Edhe kur është i etur edhe kur nuk është. Edhe kur është i sëmurë, edhe kur është i shëndoshë. Prindërit e tij, për dallim nga disa të tjerë, nuk e detyrojnë të hajë gjëra pa lidhje, siç është spinaqi, thjerrëza, borania, sallatat etj. Ai ha çka dëshiron ai vetë, ha kur të dojë ai dhe sa të dojë ai. Kështu Dironi ha çokollatë për mëngjes, çokollatë për drekë dhe çokollatë për darkë. Zëmra e tij zakonisht është ndonjë krem ose së paku krem banane. Ose ndonjë kinder-vezë. Ndonjëherë ha edhe hamburgerë ose pica. Dhe, gjithë ditën luan në kompjuter dhe kënaqet. Ai ka shumë dëshirë të luajë në kompjuter. Më parë dilte kur e kërkonin të luajë futboll ose dilte me biçikletë, por tash disi e ka mërzi këtë.

Zdravka dëshiron të shoqërohet shumë. Për atë më e rëndësishme është shoqëria, ndihma, qeshja dhe këmbimi i sekreteve. Ajo çdoherë mund të shoqërohet: në pushim, para ndërtesës, kur është mysafir ose te ajo në shtëpi. Ajo nuk mund të durojë të qëndrojë më gjatë se pesëmbëdhjetë minuta vetë. Çka të bëj, e tillë jam – thotë ajo ☺. Për shoqëri sakrifikon çdo gjë. Edhe kohë, edhe gjumë edhe energji. Por, askush nuk mund ta detyrojë të mos jetë në shtëpi tre herë në ditë kur vihet ushqimi. Ajo kënaqet duke ngrënë. Pëlqen të hajë peshq, brumëra dhe mollë. Pi limonë dhe portokaj të shtrydhur. Kur nuk ka, pi ujë të thjeshtë.

Arta i pëlqen shumë filmat e vizatuar. Çdoherë kur ka kohë të lirë, ajo shikon filma të vizatuar. Në televizion, në DVD, në internet... Është e fascinuar nga kreativiteti dhe llojllojshmëria e filmave të vizatuar. Një ditë edhe vetë dëshiron të bëjë filma të vizatuar. Thjesht harrohet në to. Ndonjëherë mbetet me ato filma deri vonë në mbrëmje. Pastaj fle gjithë ditën. Pasi që i shkoi ndër mend se mund të hajë edhe derisa shikon filma të vizatuar, ajo tash nuk humb kohë as për ushqim. Ha para ekranit. Në fakt kur i shkon mendja për ushqim. E kur të kujtohet për këtë, harrohet duke ngrënë. Më shpesh ha gjëra për përtypje. Ka një kohë të gjatë që nuk e ka vozitur biçikletën dhe që nuk ka dalë para ndërtesës.

Arbeni është i dashuruar në natyrë dhe në basketboll. Secilin moment të lirë e shfrytëzon për shëtitje. Nëse nuk mundet në mal, atëherë së paku del në park. Nëse nuk ka kohë për këtë, atëherë ecë në këmbë deri te rrjedha që kalon pranë fshatit të tij. Thua se secilën pasdite ai luan basketboll në oborrin e shkollës. Ai është ndër më të mirët për këtë. Por, të mirë janë edhe Anja, Safeti, Kala, Zllatku dhe Tefiku. Veçanërisht dallohet Petrulla. Vetëm ajo është më e mirë se ai nën kosh. Kur luan shumë, pastaj Arbeni është i uritur si kuçedër. Por, për dallim prej fëmijëve të tjerë që pasi të luajnë qëndrojnë në fushë që të hanë sandviçë, gjëra për përtypje dhe çipsa, Arbeni më shumë dëshiron të hajë në shtëpi. Disi më mirë i vjen. Ushqimet e tij të preferuara janë spinaqi dhe fasulja. Por, i do edhe sarmatë. Dhe, sado që është i uritur, nëse nuk ka sallatë, ai vetë e bën një. Ai mendon se ajo i ndihmon që jetë basketbollist i mirë.

Fletë pune për nxënësit IV-1.7b: Për pesë vite

Për pesë vite, _____ ishte përgjegjës/e e seksionit të ndihmës së nxënësve të tjerë. Është shumë e përkushtuar dhe shumë rregullisht dëshiron t'i vizitojë. Të gjithë do të habiten si ka aq energji për gjithçka dhe përsëri të duket aq i/e shëndoshë dhe i/e mbushur me energji. Të gjithë ia marrin lakmi.

Për pesë vite _____ do të ketë probleme me gjumin. Shpesh ngrihet natën i frikësuar. Shumë vështirë do të lëvizë nga kolltuku dhe do ta urrejë fizikulturën. Mjeku do t'i japë syze të mëdha. Një mjek tjetër do t'i rekomandojë vitamina dhe minerale që do të duhet t'i marrë si tableta, sepse ka aq shumë mungesë që nuk mund të kompensohet dot nga burime natyrore. Ai fëmijë do të jetë gjithnjë e më i dobët. Asnjë ftohje ose grip nuk do t'i ikë.

Për pesë vite _____ do të ketë seriozisht më shumë kilogramë se fëmijët e tjerë në klasë. Ky edhe nuk do të jetë ndonjë problem nëse mund të vrapojë në orët e edukatës fizike së paku sa gjysma e asaj që ka mundur të vrapojë para pesë viteve. Dhëmbët do t'i prishen dhe lëkura do t'i zbehet. Shumë shpesh pa asnjë shkak do të jetë nervoz. Do të shpërthejë dhe do të bërtasë. Po ashtu shumë shpesh nuk do të mund të kuptojë se për çka flasin fëmijët e tjerë. Mjekët i rekomandojnë vitamina, minerale dhe aktivitet fizik.

Për pesë vite për _____ do të dijë gjithë shkolla. Do të jetë njëri nga fëmijët më simpatikë dhe më të qetë. Çdoherë do të jetë i buzëqeshur dhe i gatshëm për të ndihmuar. Në veçanti do të shkëlqejë qetësia dhe kthjelltësia e tij. Të gjithë do ta duan. Do të jetë këtu për të gjithë dhe çdoherë do të duket i pushuar dhe i shëndetshëm. Ai nuk është sëmure asnjëherë në pesë vitet e fundit.



Fletë pune për nxënësit IV-2.3: Si lahen dhëmbët?



DHËMBËT E SIPËRM
NGA PJESA E BRENDSHME




DHËMBËT E POSHTËM
NGA PJESA E BRENDSHME




SIPËRFAQJA ME TË
CILËN HANI




PJESA E JASHTME




Fletë pune për nxënësit IV-2.4a: Vishni fëmijët




Fletë pune për nxënësit IV-2.4b: Veshja adekuate 1






Fletë pune për nxënësit IV-2.4ç: Veshja adekuate 3




Fletë pune për nxënësit IV-2.4d: Veshja adekuate 4







Fletë pune për nxënësit IV-2.5a: Veshja 1




Fletë pune për nxënësit IV-2.5b: Veshja 2



Fletë pune për nxënësit IV-2.5c: Veshja 3



Fletë pune për nxënësit IV-3.2: Visheni Zdravkën



- **Çka e ka shkaktuar gjendjen?**



- **Si ndjehet fëmija që është në gjendje të tillë?**

- **Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur?**

- **Çfarë gjërash i kanë rekomanduar të bëjë?**

- **Çka e ka shkaktuar gjendjen?**




- **Si ndjehet fëmija që është në gjendje të tillë?**

- **Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur?**

- **Çfarë gjërash i kanë rekomanduar të bëjë?**

- **Çka e ka shkaktuar gjendjen?**



- **Si ndjehet fëmija që është në gjendje të tillë?**
- **Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur?**
- **Çfarë gjërash i kanë rekomanduar të bëjë?**

Fletë pune për nxënësit IV-4.3: Puberteti – kuiz

1. Kur fillon puberteti?

- A) te të gjithë fëmijët përnjëherë
- B) te vajzat më herët se të djemtë
- C) të djemtë më herët se te vajzat
- Ç) te të gjithë fëmijët kur t'i mbushin 10 vjet

2. Çka nuk është karakteristike për djemtë dhe vajzat në pubertet?

- A) fillojnë të tajitin hormone seksuale
- B) shfaqen ndryshime të shpeshta në disponimin e tyre
- C) fillojnë të paraqiten simpatitë
- Ç) u rriten "dhëmbët e mendjes"

3. Kur paraqitet ndjenja e joshjes seksuale?

- A) menjëherë pas lindjes
- B) në pubertet
- C) pas vitit të 20-të të jetës
- Ç) në pleqëri

4. Si quhet cikli mujor që paraqitet te vajzat në pubertet?

- A) sekrecion
- B) diskrekcion
- C) menopauzë
- Ç) menstruacion

5. Sa shpesh në muaj vajzat kanë cikle mujore gjatë pubertetit?

- A) rregullisht, në çdo dy muaj
- B) rregullisht, një herë në vit
- C) kryesisht çdo javë nga një herë
- Ç) jorregullisht, por kryesisht një herë në muaj

6. Si quhet paraqitja e shqetësimit spontan seksual te djemtë, e cila mund të shfaqet kohë pas kohe?

- A) rekreacion
- B) sekrecion
- C) ereksion
- Ç) ejakulim

7. Çka është masturbimi?

- A) prodhimi i spermës nga organi seksual mashkullor
- B) derdhja e një lëngut faror gjatë gjumit
- C) tajitje e tepërt e hormoneve seksuale në gjak
- Ç) vetëkënaqësia e pasionit seksual

8. Për masturbimin është e saktë se:

- A) paraqitet edhe te meshkujt edhe te femrat
- B) e shpenzon gjithë spermën e prodhuar
- C) nëse teprohet, mund ta thajë palcën kurrizore
- Ç) nuk është paraqitje natyrore, por një akt i turpshëm

9. Heteroseksualiteti është joshje seksuale:

- A) për personat e gjinisë së kundërt
- B) për personat e gjinisë së njëjtë
- C) për personat e të dyja gjinive njëherazi
- Ç) ndaj fëmijëve të vegjël

10. Për homoseksualitetin është e saktë se është:

- A) paraqitje jonatyrore
- B) sëmundje e mendjes
- C) ves i ligë i kohës sonë
- Ç) orientim i veçantë seksual

11. Çka nuk është e saktë për lojërat seksuale ndërmjet moshatarëve në pubertet?

- A) i bëjnë shumica e fëmijëve, por fshehurazi
- B) i bëjnë vetëm djemtë
- C) zakonisht nuk diskutohen me të rriturit
- Ç) mund të bëhen edhe mes personave të gjinisë së njëjtë

12. Si quhet dukuria kur njerëzit e rritur i mashtrojnë fëmijët për aktivitete seksuale?

- A) pedofili
- B) ksenofobi
- C) filantropi
- Ç) homofobi

13. Kur ka ndonjë vajzë cikël mujor?

- A) ndonjëherë kjo mund të vërehet prej së largu
- B) çdoherë dallohet dhjetë hapa larg
- C) assesi nuk mund të dallohet prej anash
- Ç) te disa vajza mund të vërehet

14. Për vajzat është e shëndetshme të kenë marrëdhënie seksuale:

- A) pas ciklit të parë mujor
- B) pas dhjetë cikleve të rregullta mujore
- C) kur të ndjehen të gatshme
- Ç) pasi të martohen

15. Për djemtë është e shëndetshme të kenë marrëdhënie seksuale:

- A) pas ereksionit të parë
- B) pas ejakulimit të parë
- C) kur të ndjehen të gatshëm
- Ç) pasi të martohen

16. Vajzat mund ta prekin organin e tyre seksual vetëm:

- A) me duar të pastra
- B) pasi të martohen
- C) nëse e kanë patjetër
- Ç) nën kërcënim të madh

17. Djemtë mund t'i shprehin ndjenjat e tyre haptazi vetëm:

- A) para pasqyrës
- B) para shokut më të mirë
- C) nëse dëshirojnë
- Ç) në rast të ndonjë fatkeqësie të madhe

18. Është në rregull t'i mbushësh mendjen dikujt të bëjë diçka që nuk dëshiron vetëm nëse:

- A) të pëlqen shumë
- B) të provokon
- C) në asnjë rast nuk është në rregull
- Ç) mendon se do t'i pëlqejë

Fletë pune për nxënësit IV-4.5a: Saktë-Pasaktë 1

Shqetësim seksual shfaq arsimtari/arsimtarja kur....

1.	... me celularin e vet i fotografon nxënësit derisa ata përgjigjen në tabelë ose bëjnë diçka tjetër.	S	P
2.	... para nxënësve tregon barsoleta me përmbajtje seksuale.	S	P
3.	... i jep vërejtje ndonjë nxënësit pse është shumë i gjatë.	S	P
4.	... nxënësve ua lexon porositë e telefonave të tyre, ku mund të ketë edhe porosi nga simpatitë.	S	P
5.	... në orët e biologjisë u ligjëron nxënësve për atë se si bëhet bebet.	S	P
6.	...i lexon mesazhet nëpër letra, që nxënësit ia dërgojnë njëri-tjetrit në lidhje me simpatitë e tyre.	S	P
7.	...gjatë orës së edukatës fizike i prek nxënësit në organet e tyre seksuale ose në gjok derisa u ndihmon të bëjnë ndonjë ushtrim.	S	P
8.	... komenton për pamjen fizike të ndonjë nxënësi/nxënëseje, veçanërisht për ato pjesë të trupit që zhvillohen në pubertet.	S	P
9.	... në orët e edukatës fizike i kap nxënësit për dore që t'u tregojë se si hidhet topi.	S	P
10.	... bën komplimente për pamjen fizike të trupit të disa nxënësve.	S	P
11.	... i lavdëron nxënësit që mësojnë mirë.	S	P
12.	... hy në gardërobat (të meshkujve ose të femrave) pa paralajmërim (pa trokitur ose pa marrë leje).	S	P
13.	... i përqafton nxënësit, pa marrë parasysh a janë të gjinisë së njëjtë ose të kundërt më të.	S	P
14.	... i detyron nxënësit të mbeten në shkollë pas orëve me qëllim që t'u ndihmojë të mësojnë.	S	P
15.	... u tregon nxënësve materiale me përmbajtje seksuale që nuk kanë lidhje me mësimin.	S	P
16.	... i mban në krah nxënësit kur lëndohen ose kur nuk mund të ecin.	S	P
17.	... jep këshilla për tema seksuale jashtë përmbajtjeve mësimore.	S	P
18.	... i fton nxënësit në takime të veçantë, pa pasur nevojë për këtë.	S	P

Fletë pune për nxënësit IV-4.5b: Saktë-Pasaktë 2

Shqetësim seksual kemi kur një nxënës/nxënëse ose një grup nxënësish....

1.	... me telefonin e tyre fotografojnë nxënës të tjerë pa marrë leje për këtë.	S	P
2.	... para nxënësve të tjerë tregojnë mahi ose ngjarje me përmbajtje seksuale dhe atëherë kur të tjerët nuk dëshirojnë të dëgjojnë.	S	P
3.	... këmbëjnë porosi SMS mes vete për simpatitë e tyre.	S	P
4.	... nxënësve të tjerë u dërgojnë porosi SMS të pakëndshme me përmbajtje seksuale.	S	P
5.	... diskutojnë mes vete për atë se si bëhen bebet.	S	P
6.	... i lexojnë para të tjerëve fletat me porosi që nxënësit ia dërgojnë njëri-tjetrit në lidhje me simpatitë e tyre, pa marrë leje nga ata që janë përmendur në porosi.	S	P
7.	... përpiqen ta zhveshin ndonjë nxënës/nxënëse pa dëshirën e tij/saj.	S	P
8.	... bëjnë komente për pamjen fizike të ndonjë nxënësi/nxënëseje, veçanërisht për ato pjesë të trupit që zhvillohet në pubertet.	S	P
9.	... e puthin ndonjë nxënës/nxënëse që e dëshiron atë.	S	P
10.	... flasin për pamjen e ndonjë nxënësi/nxënëseje në atë mënyrë që ai/ajo të ndjehet jo mirë.	S	P
11.	... flasin me të tjerët për anët e mira të ndonjë nxënësi/nxënëseje.	S	P
12.	... qëllimisht e lënë të hapur derën e tualetit derisa ndonjë nxënës është aty.	S	P
13.	... e prekin ndonjë nxënës/nxënëse në kundërshtim me vullnetin tij në mënyrë që ai/ajo të ndjehet keq.	S	P
14.	... i ftojnë simpatitë e veta të bëjnë diçka bashkërisht.	S	P
15.	... në kundërshtim me vullnetin e tyre, nxënësve të tjerë u tregojnë fotografi ose filma me përmbajtje seksuale.	S	P
16.	... e vizitojnë në shtëpi ndonjë nxënës/nxënëse që t'i ndihmojnë për detyrat e shtëpisë.	S	P
17.	... përhapin gënjeshtër për atë se kush kë e ka simpati.	S	P
18.	... nxënësve të tjerë u shfaqin gjeste të padëshiruar dhe të pakëndshme me përmbajtje seksuale.	S	P

Fletë pune për nxënësit IV-5.1a: Dua ajër

Sarah, Xhani dhe Fani, janë në ditëlindje të Milla. Ahengu mbahet në oborrin e Millës dhe pjesa më e madhe e njerëzve aty luajnë ping-pong në disa tavolina. Prindërit e Millës dhe disa fqinj përreth shikojnë se si po luajnë ata ping-pong dhe si pinë duhan. Sarah, Xhani dhe Fani dëshirojnë të luajnë ping-pong, por nuk dëshirojnë të thithin tym. Çka mund të bëjnë?

Arsimtarja e dërgon Zhakin dhe Lulin në zyrën e arsimtarëve që të sjellin harta historike. Zhaku dhe Luli e dinë se atje disa arsimtarë pinë duhan. Ata e dinë se atyre u kundërmojnë teshat erë duhani derisa i kërkojnë hartat dhe, natyrisht, nuk u pëlqen. Çka mund të bëjnë Zhaku dhe Luli?

Nëna e Arbenit është e zënë të martën kur Arbeni duhet të të shkojë në karate. Ajo është marrë vesh që fqinja e tyre ta marrë Arbenin në karate. Por, fqinja po ashtu ka qenë e zënë dhe bashkëshorti i saj është paraqitur dhe i ka thënë se ai do ta sjellë. Arbeni e di se fqinji pi duhan në veturën e tij dhe vërtet nuk ka dëshirë të udhëtojë në veturë të tymosur. Çka mund të bëjë Arbeni?

Dançeja dhe Kanita shkuan në ëmbëltore të hanë sallatë pemësh. Shitësi në ëmbëltore i pyeti se a dëshirojnë të hanë brenda apo t'u mbështjellë për në shtëpi. Dançeja dhe Kanita e shohin se brenda në ëmbëltore ka njerëz që pinë duhan, madje edhe në tavolinat jashtë ka shumë tym. Çka mund të vendosin të bëjnë?

Është mbrëmje. Zana dhe Jana dëshirojnë të dalin në qytet. Atyre u paraqitet Ivani dhe i fton në ditëlindje, në klub përballë kinemasë. Jana dhe Zana duan të shkojnë, por e dinë se në shoqërinë e Ivanit ka disa fëmijë që pinë duhan dhe se atje do të ketë shumë tym. Çka mund të bëjnë Zana dhe Jana?

Fletë pune për nxënësit IV-5.1b: „Kur do të...”

- ◆ Kur të na vijnë mysafirë dhe të ndezin cigare, unë do t'u...
- ◆ Kur dikush do të më ofrojë cigare, unë do t'i...
- ◆ Kur do të hyj në shitore dhe ndjej aromë cigareje, unë....
- ◆ Kur do të hipi në taksi/veturë ku është pirë/pihet duhan, unë...
- ◆ Kur do të hipi në autobus dhe shoh se shoferi pi duhan, unë....
- ◆ Kur do shoh se ndonjë fëmijë pi duhan, unë...
- ◆ Kur do shoh se dikush i shet cigare ndonjë fëmije....
- ◆ Kur do të hyj në restorant/ëmbëltore ku pihet duhan, unë....
- ◆ Kur do të shkoj mysafir diku ku pihet duhan, unë....
- ◆ Kur do të hyj në tualetin shkollës dhe do shoh se dikush pi duhan aty, unë....
- ◆ Kur dikush që më shet ushqim, e mban në gojë një cigare, unë do të...

Fletë pune për nxënësit IV-5.2: Pesë personazhe

Në fleta të veçanta vizatoni personazhet e dhëna më poshtë ashtu si mendoni se do të duhej të dukeshin në të vërtetë:

Person që tashmë dhjetë vite merret me alpinizëm/not/skijim.





Person që në njëzet e pesë vitet e kaluara i pi nga dy paketa cigare në ditë.

Person që dhjetëra vite merret me jogë dhe me vozitje të biçikletës.





Person që në pesëmbëdhjetë vitet e fundit konsumon alkool në sasi të mëdha.

Person që në shtatë-tetë vitet e fundit trajnon kar.



Shtoni idetë tuaja






Shtoni idetë tuaja





Shtoni idetë tuaja



Shtoni idetë tuaja



Shtoni idetë tuaja



UJI I BURIMIT ËSHTË I NDOTUR DHE, NËSE NJERIU E PI, MUND TË KETË TEMPERATURË DHE SËMUNDJE NË BARK.	GURËT E RRJEDHËS SË NJË PËRROSKE JANË SHUMË TË LËMUAR DHE NJERIU MUND TË RRËSHQASË, TË RRËZOHET NË TO DHE TA THYEJË KËMBËN DERISA PËRPIQET TA KALOJË ATË.
DHJETË METRA MË TEJ NË RRUGË KA NJË VRIMË TË MADHE, NË TË CILËN MUND TË BIE MAKINA NËSE VAZHDON TË ECË ME ATË SHPEJTËSI.	URA MBI LUMË NUK ËSHTË AQ E FORTË DHE, NËSE NJERIU PËRPIQET TA KALOJË ME MAKINË, URA DO TË RRËZOHET DHE NJERIU ME MAKINË DO TË BIE NË LUMË.
NË BARIN E LIVADHIT KA BIMË HELMUESE DHE, NËSE NJERIU NË TË ECË ME PANTALLONA TË SHKURTRA, DO T'I DIGJEN KËMBËT.	NË ATË PJESË TË MALIT KA SHUMË BLETË QË MUND TË KAFSHOJNË. NËSE NJERIU ËSHTË ALERGJIK, MUND EDHE TA PËSOJË.
NËSE DËSHIRON TA KALOJË RRUGËN NË VIJAT E KËMBËSORËVE, PATJETËR DUHET TE KETË KUJDES QË MOS T'I VIJË NDONJË MAKINË, SEPSE MUND TA PËSOJË.	NËSE DËSHIRON TË NGASË BIÇIKLETË NË RRUGË, DUHET TË KETË SHUMË KUJDES NDAJ MAKINAVE, SEPSE MUND TË NDODHË QË NDONJË VETURË EDHE TA SHKELË.

Fletë pune për nxënësit V-1.2b: Rruga ime deri në shkollë



Fletë pune për nxënësit V-1.3a: Siguria në komunikacion 1

Çka duhet të bëjë fëmijë kur shkon në shkollë në këmbë?

- Të ecë në anën e majtë të rrugës.
- Të ecë në anën e djathtë të rrugës.
- Të mbajë helmete mbrojtëse.
- Të mbajë mburojë për bërrylat dhe gjunjët.
- Të lidhet me rrip për karrige.
- Të ketë kujdes të mos ndeshet në diçka.
- Të ketë kujdes të mos i bie dikush ose diçka.
- Të mbahet për mbajtës.
- Të ulet në karrigen e prapme.
- Ta kalojë rrugën në shtegun e këmbësorëve.
- Të ecë në shtegun e shënuar.
- Të lëvizë nëpër trotuar.
- Të ketë kujdes të mos e sulmojë ndonjë qen.
- Të kalojë në dritë të gjelbër.
- Të shmanget nga bisedat me të panjohurit.
- Të ketë kujdes të mos e shkelë dikë.
- Ta konfirmojë se dera e ulëses së tij/saj është e mbyllur.
- Të ketë kujdes të mos e stërpikë dikë.
- T'u lirojë vend më të moshuarve.
- Të ketë kujdes në kuletën e tij.
- Të mos vozitë shpejt dhe me rrezik.
- Të mos vrapojë pa mend.
- Të refuzojë ta marrë dikë me vete, se pse kjo nuk është e sigurt.
- Të mos flasë me shoferin.
- Të mos dëgjojë muzikë në veshë, se kjo nuk është e sigurt.

Fletë pune për nxënësit V-1.3b: Siguria në komunikacion 2

* Çka duhet të bëjë fëmijë kur vozitet vetë me autobus?

- Të ecë në anën e majtë të rrugës.
- Të ecë në anën e djathtë të rrugës.
- Të mbajë helmete mbrojtëse.
- Të mbajë mburojë për bërrylat dhe gjunjët.
- Të lidhet me rrip për karrige.
- Të ketë kujdes të mos ndeshet në diçka.
- Të ketë kujdes të mos i bie dikush ose diçka.
- Të mbahet për mbajtës.
- Të ulet në karrigen e prapme.
- Ta kalojë rrugën në shtegun e këmbësorëve.
- Të ecë në shtegun e shënuar.
- Të lëvizë nëpër trotuar.
- Të ketë kujdes të mos e sulmojë ndonjë qen.
- Të kalojë në dritë të gjelbër.
- Të shmanget nga bisedat me të panjohurit.
- Të ketë kujdes të mos e shkelë dikë.
- Ta konfirmojë se dera e ulëses së tij/saj është e mbyllur.
- Të ketë kujdes të mos e stërpikë dikë.
- T'u lirojë vend më të moshuarve.
- Të ketë kujdes në kuletën e tij.
- Të mos vozitë shpejt dhe me rrezik.
- Të mos vrapojë pa mend.
- Të refuzojë ta marrë dikë me vete, se pse kjo nuk është e sigurt.
- Ë mos flasë me shoferin.
- Të mos dëgjojë muzikë në veshë, se kjo nuk është e sigurt.

Fletë pune për nxënësit V-1.3c: Siguria në komunikacion 3

* Çka duhet të bëjë fëmijë kur vozit biçikletë

- Të ecë në anën e majtë të rrugës.
- Të ecë në anën e djathtë të rrugës.
- Të mbajë helmete mbrojtëse.
- Të mbajë mburojë për bërrylat dhe gjunjët.
- Të lidhet me rrip për karrige.
- Të ketë kujdes të mos ndeshet në diçka.
- Të ketë kujdes të mos i bie dikush ose diçka.
- Të mbahet për mbajtës.
- Të ulet në karrigen e prapme.
- Ta kalojë rrugën në shtegun e këmbësorëve.
- Të ecë në shtegun e shënuar.
- Të lëvizë nëpër trotuar.
- Të ketë kujdes të mos e sulmojë ndonjë qen.
- Të kalojë në dritë të gjelbër.
- Të shmanget nga bisedat me të panjohurit.
- Të ketë kujdes të mos e shkelë dikë.
- Ta konfirmojë se dera e ulëses së tij/saj është e mbyllur.
- Të ketë kujdes të mos e stërpikë dikë.
- T'u lirojë vend më të moshuarve.
- Të ketë kujdes në kuletën e tij.
- Të mos vozitë shpejt dhe me rrezik.
- Të mos vrapojë pa mend.
- Të refuzojë ta marrë dikë me vete, se pse kjo nuk është e sigurt.
- Të mos flasë me shoferin.
- Të mos dëgjojë muzikë në veshë, se kjo nuk është e sigurt.

Fletë pune për nxënësit V-1.3ç: Siguria në komunikacion 4

* Çka duhet të bëjë fëmijë kur vozitet me veturë?

- Të ecë në anën e majtë të rrugës.
- Të ecë në anën e djathtë të rrugës.
- Të mbajë helmete mbrojtëse.
- Të mbajë mburojë për bërrylat dhe gjunjët.
- Të lidhet me rrip për karrige.
- Të ketë kujdes të mos ndeshet në diçka.
- Të ketë kujdes të mos i bie dikush ose diçka.
- Të mbahet për mbajtës.
- Të ulet në karrigen e prapme.
- Ta kalojë rrugën në shtegun e këmbësorëve.
- Të ecë në shtegun e shënuar.
- Të lëvizë nëpër trotuar.
- Të ketë kujdes të mos e sulmojë ndonjë qen.
- Të kalojë në dritë të gjelbër.
- Të shmanget nga bisedat me të panjohurit.
- Të ketë kujdes të mos e shkelë dikë.
- Ta konfirmojë se dera e ulëses së tij/saj është e mbyllur.
- Të ketë kujdes të mos e stërpikë dikë.
- T'u lirojë vend më të moshuarve.
- Të ketë kujdes në kuletën e tij.
- Të mos vozitë shpejt dhe me rrezik.
- Të mos vrapojë pa mend.
- Të refuzojë ta marrë dikë me vete, se pse kjo nuk është e sigurt.
- Të mos flasë me shoferin.
- Të mos dëgjojë muzikë në veshë, se kjo nuk është e sigurt.

Fletë pune për nxënësit V-1.5: Është me rëndësi të dihet

Emili i ka 9 vjet. Ai tashmë është rritur. Megjithatë jo aq sa të mund të rrijë gjithë pasditen vetë në shtëpi. Por, njëherë ndodhi që, derisa ai ishte në shkollë, prindërit e tij, që po ktheheshin nga një qytet tjetër, u gjetën para një pengese të pakalueshme. Një cisternës së madhe i kishte rrjedhë një sasi e madhe e naftës dhe derisa të pastrohej rruga askush nuk mund të kalonte. Edhe pse nëna dhe babai i tij ishin larg tij jo më shumë se 20 kilometra, ato iu paraqitën dhe i thanë se deri në mbrëmje do të duhet të qëndrojnë vetë në shtëpi. I kërkuan falje dhe e pyetën se a dëshiron ta ftojë dikë të shkojë te ai në shtëpi. Ai u tha se nuk ka nevojë dhe se gjithçka do të jetë në rregull. Ata i thanë të ketë kujdes ndaj vetvetes.

Në çka duhet të ketë kujdes Emili derisa është vetë në shtëpi?

Kanitës i vjen një kushërirë nga një vend i huaj. Qyshkur ka qenë për herë të fundit, Kanita e di se ajo është një vajzë e mirë, por është pak kryelartë. Prandaj Kanita vendosi që kësaj radhe ta qetësojë duke e dërguar në koncert me muzikë rok të grupit për të cilinë gjithë thoshin se është grupi më i mirë në botë, ashtu që ajo do ta shohë se edhe në Maqedoni ka gjëra cilësore. Por, ekzistonte një problem i vogël – Kanita asnjëherë deri tash nuk kishte qenë në koncerte të rokut. Epo, mirë, sikur vetëm ajo është fëmija i vetëm 11-vjeçar që nuk ka qenë në çfarëdo koncerti të rokut.

Në çka duhet të ketë kujdes Kanita derisa është në koncert të rokut? Koncerti do të jetë në një sallë të madhe dhe aty do të ketë shumë njerëz.

Arta dhe Marku e pëlqejnë shumë futbollin. Ata çdo ditë gjatë gjithë verës luajnë futboll. Por, edhe luajnë mirë. Në turneun e shkollës, ku ekipi i tyre fitoi, qysh më parë ishte thënë se fëmija që do të shënojë më shumë gola, do t'i fitojë dy bileta për derbin e madh të qytetit të organizuar nga lidhja e futbollit. Mirë, por Arta dhe Marku të dy i kishin shënuar nga shtatë gola. Logjikisht të dy duhej të merrnin nga një biletë. Megjithatë këtu kishte një problem të vogël, sepse ata asnjëherë nuk kishin marrë pjesë vetë në një ngjarje të këtillë. E meqë ishte derbi, nuk kishte më bileta që ndonjëri nga prindërit e tyre të shkojë bashkë me ata. Prandaj duhej ose ndonjëri nga ata të heqë dorë nga bileta e tij ose të shkojnë të dy, por vetë. Kuptohet asnjëri prej tyre nuk hiqte dorë nga bileta.

Në çka duhet të kenë kujdes dhe si duhet të sillen Marku dhe Arta derisa janë në stadium për ta shikuar derbin?

Vllatka sapo është shpërngulur në qytetin tonë. Ndërsa ka ardhur nga skaji tjetër i botës. Ajo që nga mosha e saj si foshnjë e deri tash, deri në moshën nëntëvjeçare, ka jetuar vetëm atje. Siç na tregon ajo vetë, këtu shumë gjëra janë të ndryshme dhe disa sjellje të njerëzve asaj i duken shumë të reja dhe të pazakonshme. Jane e ftoi Vllatkën në ditëlindje të premtën në orën 19. Edhe pse nuk dëshironte të pranojë, Vllatkës i pëlqeu Jane. Por, as Janeja nuk e ftoi për “kot” 😊.


Si duhet të sillet Vllatka në ditëlindjen dhe në çka duhet të këtë kujdes?

Lea i ka vetëm tetë vjet. Ajo është një fëmijë super. Ajo e ka edhe një gjyshe super “të çuditshme”. Përveç që vazhdimisht i bën mahi dhe truke, gjyshja e saj i ka edhe disa sjellje të çuditshme. Për shembull, Lea duhet të shkojë në ekskursion nëpër gjithë Maqedoninë. Ekskursioni zgjat 5 ditë. Prindërit e Leas thuajse as nuk brengosen, ndërsa gjyshen e saj fare nuk e merr gjumi nga derti se Lea do të jetë aq gjatë “vetë”. Edhe pse Lea e di se nuk do të jetë vetë, këtë assesi nuk ëe kupton gjyshja e saj.

Si mund t’ia shpjegojë Lea gjyshes së saj se i di gjërat për të cilat duhet të ketë kujdes derisa është në ekskursion.

Sofija, Aja dhe Kemoja për herë të parë ngelin vonë jashtë. Ora është 22. Ata i kanë nga katërmëdhjetë vite dhe nuk dëshirojnë të kuptohet se ata kanë problem. Por, ata kanë problem. Do të duhet të kthehen në shtëpi në këmbë. Nuk është aq larg – ata jetojnë pesëmbëdhjetë minuta nga piceria ku ishin, por kanë pak frikë, sepse në terr gjërat u duken më ndryshe dhe nuk janë të sigurt se çfarë rreziqe i presin.

Në çka duhet të kenë kujdes Sofija, Aja dhe Kemoja derisa kthehen në shtëpi?



Fletë pune për nxënësit V-1.7: Armët

Marija dhe Orhani thjesht kënaqen duke u shëtitur në natyrë. Secilin vikend, kur nuk kanë mësimë ose detyrime të tjera, ata e kalojnë kohën me shëtitje në natyrë. Edhe atë të shtunë ata u shëtitën thuaja gjithë ditën dhe, derisa në pasditen e vonshme po ktheheshin në shtëpi, Marija propozoi të ulen dhe të pushojnë pranë një ahu të madh. Ishte shumë mirë të qëndrosh nën hijen e tij.

Edhe druri linte përshtypje të madhe me format e ndryshme që i bënin degët dhe rrënjët e tij. Ata filluan t'i vëzhgojnë ato. Përnjëherë Marija i foli me zë të lartë Orhanit: "Shih Orhan, eja shpejt!" Marija e frikësuar, por edhe kureshtare, po ia tregonte atij një vrimë të madhe në dru ku kishte diçka që ngjante në një bombë të ndryshkur dhe të vjetër.

A ka rrezik për sigurinë e tyre në këtë situatë?

Si duhet të veprojnë Marija dhe Orhani?

Tanja i ka njëmbëdhjetë vjet. Ajo ka shumë dëshirë të hulumtojë në tavanin e shtëpisë së gjyshit dhe gjyshes së saj në fshat. Ky tavan për të sikur e fsheh sekretin e sekreteve. Asaj i duket si shumë misterioze dhe romantike kjo punë që e nxit të prekë dhe të kërkojë, t'i shohë gazetatat dhe revistat e ku ta dish para së viteve dhe ballinat qesharake-naive të librave të asaj kohe. Ajo kënaqet duke i fryrë pluhurit të kutive të vjetra: edhe pse është shumë nxehtë dhe plot me pluhur gjithkund përreth saj. Ashtu e hutuar, Tanja e hapi një kuti të drunjtë dhe brenda saj e gjeti një pistoletë.

A është Tanja e rrezikuar?

Si duhet të veprojë Tanja në këtë situatë?

Zudiu është nxënës i klasës së pestë. Ai e pëlqen matematikën dhe hendbollin. Historia nuk i shkon mirë, ndërsa anglishtja ashtu-ashtu. Ai dëshiron të bëhet matematikan. Hendbolli për të është vetëm një lloj hobi ose argëtimi. Ai e ka shumë me rëndësi që të jetë i dukshëm në shkollë, për çka filloi t'i pëlqejë Sarës. Në këtë periudhë në shkollë është në "modë" që disa fëmijë të mbajnë thika. Zudiu e di se, nëse e merr me vete thikën e gjuetisë që gjyshi i tij e mban në garazhe, të gjithë do t'ia kenë lakmi. Thikë të tillë të mirë dhe të madhe nuk ka askush. Por ka dilema, mendon dhe nuk di si të vendosë.

A është Zudiu i rrezikuar?


Si duhet të veprojë në këtë situatë?

A është vetëm Zudiu i rrezikuar në këtë përrallë? Prej kujt?


Macja




1




2



3




4




Ktheje

5




Mjellma


1




2




3



4




5



Tulipani




1



2




3



5




4




Mbështille kah
ana e jashtme

Bretkosa

1




4




Njësoj edhe në anën tjetër

2




5




Ktheje


3




6




Krapi



1




2




3




4



5



Fletë pune për nxënësit V-3.2: FJALËKRYQI



Horizontalisht:

- 3- njëri nga zogjtë më inteligjentë, i zi, shumë i dobishëm dhe me çerdhe nëpër drurë
- 4- peshku më i njohur Liqenit të Ohrit – i ndaluar për peshkim
- 6- krijesa shume të vogla, të vyeshe dhe të dashura (në shumës)
- 11- kafshë shumë e dobishme që njerëzit e mbysin pa mëshirë – këndon shumë mirë në hënë dhe jeton në tufë
- 12 - një mace e bukur, e egër, që mund të shihet shumë rrallë
- 14 - një shpend i bukur grabitqar, me shikim shumë të mprehtë (më i vogël se shqiponja) dhe me ngjyrë kafeje

Vertikalisht:

- 1- shpend që e bën çerdhen nëpër shtylla dhe oxhaqe, ndërsa në vjeshtë shkon në jug, në Afrikë
- 2 – endësja më e mirë ndërmjet insekteve, prej së cilës fëmijët frikësohen pa arsye
- 3- një kafshë e shkathtë dhe e bukur që i pëlqen shumë lajthitë
- 5- kafshë që është shumë e dobishme, ndërsa njerëzit e konsiderojnë për të dëmshme dhe dinake
- 7- një gjarpër helmues
- 8- postieri më i mirë ndërmjet zogjve
- 9- një kafshë e madhe dhe e dashur – ha shumë mjaltë dhe miza
- 10 - shpendi më i madh që jeton te ne – është i bardhë dhe jeton pranë ujërave
- 13 - kafshë e zbutur prej njeriut në fillim të historisë

Muret e dhomës janë të pastra (pa shkarravina) dhe janë të lyera me ngjyrë të bukur pasteli.	Në mure janë varur piktura ose gjëra të tjera për stolisje.	Në raftet e murit ka libra dhe stoli (të blera dhe të bëra).
Gjatë ditës krevati i gjumit është i mbuluar me mbulesë të bukur.	Mbi krevat është një dritë për të lexuar në mbrëmje.	Dritaret janë pastra dhe nën to ka saks me lule.
Në dhomë nuk ka veshje të shkapërderdhura – veshja është në vendin e saj në raft.	Në tavolinën e punës nuk ka libra, fletore, lapsa goma e gdhendëse të shkapërderdhura...	Të gjitha lodrat që nuk përdoren për lojë janë në vendin e tyre.

Fletë pune për nxënësit V-4.1b: Klasa jonë

Muret janë të pastra (pa shkarravina) dhe të lyera me ngjyrë të bukur pasteli.	Në mure janë varur punime të ndryshme të nxënësve.	Dritaret e klasës janë pastra dhe nën to ka saksì me lule.
Bankat dhe karriget çdoherë janë në vendin e tyre.	Bankat dhe karriget nuk janë shkarravitur dhe nuk janë grithur.	Nëpër banka nuk ka libra, fletore, lapsa goma e gdhendëse të shkapërderdhura...
Dyshemeja është e pastër dhe të gjitha mbeturinat janë në vendin e tyre – në koshin e mbeturinave.	Jaknet e nxënësve janë të varura në varëse, ndërsa çantat me libra janë nën banka.	Gjatë festave klasa është e stolisur me punime të nxënësve.

Fletë pune për nxënësit V-5.3: Këshilla për përdorimin më racional të ujit

- » Mos e lini çezmën të lëshuar derisa i lani dhëmbët!
- » Mendoni mirë a do të laheni në vaskë të mbushur me ujë (100-200 litra) apo do të bëni vetëm dush (rreth 80 litra)!
- » Mos hidhni mbeturina në kanalizim!
- » Para se t'i lani enët, mënjanoni papastërtitë nga secila enë!
- » Mos i lini enët e përdorura nën ujë që rrjedh; më mirë mbusheni lavamanin dhe vendosni aty! Kështu do të kurseni rreth 50% ujë.
- » Nëse përdorini makinë për larjen e enëve, përdoreni vetëm kur ta mbushni plot me enë!
- » Përdorni kovë, sfungjer dhe shkumë që ta lani veturën! Zorrën me ujë përdoreni vetëm kur duhet ta shpërlani!
- » Mos e përdorni ujin e ujësjellësit për ta ujitur kopshtin! Për këtë përdorni ujë nga pusi ose nga shiu i mbledhur nëpër kova!
- » Mblidheni ujin e shiut që t'i ujitni bimët nëpër saksi!
- » Mos ujitni kur fryn erë ose kur bën shumë vapë! Atëherë uji shumë shpejt avullohet.
- » Mos e ftohni ushqimin ose lëngjet me ujin e çezmës!
- » Nëse doni të keni ujë më të ftohtë për pije, mos e lini çezmën të hapur. Më mirë mbajeni një shishe me ujë në frigorifer.